



Funded by  
the European Union

# #ReLOaD

Programi Rajonal mbi Demokracinë  
Vendore në Ballkanin Perëndimor



# Udhëzues mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm



Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



Botues	© Të rinjtë për një të ardhme të Qëndrueshme
Datë	Korrik 2024
Përgatiti	Daniela Ruçi
Kontakt	Milieukontakt Shqipëri Rr. 'Xhorxhi Martini', Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Tiranë, Shqipëri Tel. +355 42 256 528 Info: <a href="mailto:office@milieukontakt.org">office@milieukontakt.org</a> Web: <a href="http://www.milieukontakt.org">www.milieukontakt.org</a>
Dizajn dhe faqosja	City Print

*Ky material është prodhuar në kuadër të projektit "Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 - ReLOaD2", i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Milieukontakt Shqipëri dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*



## Lexuesit e këtij udhëzuesi

Anëtarët e bordit të shkollës, drejtorët, mësuesit, nxënësit si edhe të gjithë partnerët e tjerë të shkollave të përfshirë në projekte me fokus mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

## Cfarë përmban udhëzuesi?

Udhëzuesi për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm është një broshurë trajnimi praktik, që ndihmon dhe motivon mësuesit dhe nxënësit, të rrisin nivelin e informimit mbi OZHQ-të, duke identifikuar objektivat specifike të OZHQ-ve dhe rëndësinë që ka mjedisi në jetën tonë. Të rinjtë luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e OZHQ-ve ata shpesh kanë perspektiva të reja të guximshme, talent dhe aftësi që mund të luajnë një rol kyç në nxitjen e ndryshimeve dhe formimin e një shoqërie më të mirë në të ardhmen.

Mësuesit do të gjejnë informacione ndihmëse mbi katër nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (6,11,13 dhe 15), për të zhvilluar orë mësimore me nxënësit e tyre. Do të gjejnë gjithashtu këshilla dhe fakte interesante nga vendi, Kosova dhe më gjerë.

Udhëzuesi prezanton aktivitete dhe lojra konkrete që të rinjtë mund të zhvillojnë për të rritur ndërgjegjësimin e tyre dhe për të treguar se si mund të kontribuojnë në arritjen e objektivave. Të rinjtë duhen të angazhohen në vizionin global të së ardhmes sepse ato janë edhe shtysa kryesore për zbatimin me sukses të tyre.



## Përmbajtja

Hyrje në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) .....	6
17 objektivat e OKB-së për transformimin e botës .....	7
Shqipëria dhe Axhenda 2030.....	9
Kosova dhe Axhenda 2030.....	9
MATERIAL TEORIK RRETH OZHQ 6: UJI I PASTËR DHE KANALIZIMET .....	11
Informacion i përgjithshëm mbi OZHQ 6.....	11
Treguesi synuar 6.1.....	14
Treguesi synuar 6.2.....	15
Treguesi synuar 6.3.....	16
Treguesi synuar 6.4.....	16
Treguesi synuar 6.5.....	17
Objektivi 6 në Shqipëri dhe Kosovë: .....	18
Aktivitetet OZHQ 6 .....	20
Aktiviteti 1: Ne jemi ujë .....	21
Aktiviteti 2: Uji ndryshon gjithçka .....	22
Aktiviteti 3: Cilin ujë do të zgjidhni ju .....	22
Aktiviteti 4: Mungesa e ujit, higjienës dhe ndikimi i tyre.....	23
Aktiviteti 5: Loja e Dilemës së ujit .....	23
Aktiviteti 6: Uji i shiut.....	24
Aktiviteti 7: Menaxhimi i integruar i Burimeve Ujore .....	25
Aktiviteti 8: Lojë me role.....	25
MATERIAL TEORIK RRETH OZHQ 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME27	
Informacion i përgjithshëm mbi OZHQ 11.....	28
Treguesi synuar 11.1.....	28
Treguesi synuar 11.2.....	29
Treguesi synuar 11.3.....	30
Treguesi synuar 11.4.....	30
Treguesi synuar 11.5.....	31
Treguesi synuar 11.6.....	31
Treguesi synuar 11.7.....	33
Aktivitetet OZHQ 11 .....	34
Aktiviteti 1: Jeta në qytet dhe jeta në fshat.....	35
Aktiviteti 2: Transporti i qëndrueshëm.....	35
Aktiviteti 3: Qytet i Zgjuar (Qytet Inteligent).....	36
Aktiviteti 4: Të njohim dhe vlerësojmë trashëgiminë .....	37

Aktiviteti 5: Kompostimi – forma më e efektshme e riciklimit të mbetjeve organike .....	37
Aktiviteti 6: Çatitë e gjelbra .....	38
MATERIAL TEORIK RRETH OZHQ 13: VEPRIMI PËR KLIMËN .....	40
Informacion i përgjithshëm mbi OZHQ 13.....	40
Treguesi synuar 13.1 .....	41
Treguesi synuar 13.2.....	42
Treguesi synuar 13.3.....	43
Aktivitete OZHQ 13 .....	45
Aktiviteti 1: Zbulo Produktet e Gjelbra.....	46
Aktiviteti 2: Ndikimi i Ndryshimeve Klimatike në Evropë.....	47
Aktiviteti 3: Shkencëtarët dhe skeptikëve e klimës.....	47
Aktiviteti 4: Ndryshimet klimatike si “Pikturë e madhe”.....	49
Aktiviteti 5: Bota pas 30 vitesh .....	49
Aktiviteti 6: Sot dhe nesër .....	50
Aktiviteti 8: Kuptojmë Gjurmën e Karbonit .....	50
Aktiviteti 9: Një konferencë për klimën .....	51
MATERIAL TEORIK RRETH OZHQ 15: JETA NË TOKË.....	54
Informacion i përgjithshëm mbi OZHQ 15.....	54
Treguesi synuar 15.1 .....	56
Treguesi synuar 15.2.....	57
Treguesi synuar 15.4.....	58
Treguesi synuar 15.5.....	60
Treguesi synuar 15.6.....	61
Treguesi synuar 15.7.....	62
Aktivitete OZHQ 15 .....	64
Aktiviteti 1: Zinxhiri Ushqimor në Natyrë .....	65
Aktiviteti 2: Shtegtimi i lejlekut .....	65
Aktiviteti .3: Një pikë: Përse na nevojitet infrastruktura e gjelbër .....	66
Aktiviteti 4: Duhet ndërtuar apo jo.....	67
Aktiviteti 5: Ekosistem natyror.....	67
Aktiviteti 6: Pyjet Evropiane .....	68
Aktiviteti 8: Ruajtja e bletëve.....	68
Aktiviteti 9: Gjenet dhe Biodiversiteti.....	69
Referenca .....	70

## Hyrje në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të)

Zhvillimi i qëndrueshëm është një koncept shumë i rëndësishëm që ka të bëjë me mënyrën se si zhvillojmë shoqërinë, ekonominë dhe kujdesemi për mjedisin për të siguruar që brezat e ardhshëm të kenë një planet të shëndetshëm.

Në botën tonë me mbi 8 miliardë njerëz, kemi arritur në një pikë ku duhet të mendojmë me kujdes se si të përdorim burimet natyrore. Revolucioni industrial ka rritur shumë popullsinë dhe ka bërë që të përdorim shumë burime natyrore, duke sjellë probleme si ndotja, varfëria dhe ndryshimet klimatike.

Zhvillimi i qëndrueshëm ka dy qëllime kryesore. Së pari, të kuptojmë dhe menaxhojmë marrëdhëniet midis ekonomisë, shoqërisë dhe mjedisit. Së dyti, të krijojmë strategji që të sigurojmë zhvillimin e dobishëm për të gjithë, pa dëmtuar planetin tonë.

Ndryshimet që kemi shkaktuar në klimë dhe në natyrë po sjellin shumë sfida për të ardhmen. Për t'i zgjidhur këto sfida, na duhet bashkëpunim dhe ide të reja.

Agjenda 2030 është një plan global i miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2015. Ky plan synon të ndihmojë zhvillimin e qëndrueshëm në të gjitha fushat: ekonomike, sociale dhe mjedisore. Kryetari i OKB-së në atë kohë, Ban Ki-Moon, e quajti Axhendën 2030 si një "plan për veprim për njerëzimin dhe planetin tonë".

Axhenda 2030 përfshin 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), që trajtojnë sfida si varfëria, pabarazia, ndryshimet klimatike dhe shëndeti. Për të arritur këto qëllime, nevojitet bashkëpunim ndërkombëtar dhe veprime të përbashkëta.



## 17 objektivat e OKB-së për transformimin e botës



Axhenda 2030 është e përbërë nga 17 objektiva konkretë të shoqëruar me 169 tregues të synuar dhe plot 248 indikatorë të matshëm.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) janë një thirrje globale për veprim, me qëllim adresimin e sfidave të planetit tonë

Objektivi 1. Eleminimi i të gjitha formave të varfërisë

Objektivi 2. Eleminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe e përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme

Objektivi 3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe

Objektivi 4. Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe nxitja e mundësive për edukim gjatë gjithë jetës për të gjithë

Objektivi 5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave

**Objektivi 6. Sigurimi i furnizimit dhe i menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë**

Objektivi 7. Sigurimi i lidhjes me energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë

Objektivi 8. Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë

Objektivi 9. Ndërtimi i infrastrukturës rezistente, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit

Objektivi 10. Zvogëlimi i pabarazisë brenda çdo vendi dhe ndërmjet shteteve

**Objektivi 11. Ndërtimi i qyteteve dhe i vendbanimeve gjithëpërfshirës, të sigurt, rezistentë dhe të qëndrueshëm**

Objektivi 12. Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit

### **Objektivi 13. Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe efektet e tyre.**

Objektivi 14. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm

### **Objektivi 15. Mbrojtja, rehabilitimi dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër shkretëtirëzimit, ndalimi e kthimi mbrapa i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit**

Objektivi 16. Promovimi i shoqërive në paqe dhe gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm, siguria e qasjes në drejtësi për të gjithë, dhe ndërtimi i institucioneve gjithëpërfshirëse, llogaridhënëse efektive në të gjitha nivelet

Objektivi 17. Fuqizimi i mjeteve të zbatimit dhe të rigjallërimit të partneritetit global për një zhvillim të qëndrueshëm

Disa prej aspekteve më të rëndësishme të OZHQ-ve (SDG) janë:

**1. Përfshirja globale:** OZHQ-të janë një përpjekje e përbashkët e të gjithë vendeve për të adresuar sfidat e përbashkëta. Për të arritur këto objektiva, ne duhet të punojmë së bashku, duke përfshirë qeveritë, organizatat ndërkombëtare, sektorin privat, shoqërinë civile dhe individët.

**2. Ndërlidhja e zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisore:** OZHQ -të synojnë të krijojnë një balancë midis zhvillimit ekonomik, mirëqenies sociale dhe ruajtjes së mjedisit. Kjo do të thotë që të gjitha këto aspekte janë të lidhura dhe duhet të trajtohen së bashku.

**3. Përballja me sfidat globale:** OZHQ -të përfshijnë sfida të tilla si varfëria, ndryshimet klimatike, barazia gjinore, edukimi, shëndetësia dhe paqja. Për të arritur këto objektiva, duhet të gjithë pa përjashtim të punojmë në nivel global dhe lokal.

**4. Ndikimi në të ardhmen:** OZHQ -të janë një investim në të ardhmen tonë. Nëse i adresojmë këto sfida tani, do të kemi një botë më të qëndrueshme dhe të drejtë për brezat e ardhshëm.

*Për më shumë informacion, mund të vizitoni: <https://albania.un.org/sq/sdgs>) <sup>1</sup>[1].*

Tek ky manual do të trajtohen më në hollësi katër prej 17 OZHQ-ve.

- **Objektivi 6.** Uji i pastër dhe kanalizime
- **Objektivi 11.** Qytete dhe komunitete të qëndrueshëm
- **Objektivi 13.** Veprimi për klimën
- **Objektivi 15.** Jeta në Tokë<sup>i</sup>



## Shqipëria dhe Axhenda 2030<sup>1</sup>

Shqipëria është plotësisht e angazhuar për zbatimin e Agjendës 2030. Parlamenti shqiptar ka miratuar njëzëri një rezolutë që konfirmon angazhimin e vendit për Agjendën 2030, pasi ajo luan një rol të rëndësishëm në arritjen e OZHQ. Janë krijuar mekanizmat institucionalë për të ndërlidhur Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) si dhe strategjitë dhe politikat sektoriale me OZHQ-të.

Mjaft punë është kryer për përafrimin e OZHQ-ve me strategjitë kombëtare dhe identifikimin e synimeve për vitin 2030 në sektorët prioritarë për procesin e zhvillimit. Është përgatitur një Raport Bazë mbi OZHQ, që vlerëson progresin e Shqipërisë në të gjitha dimensionet e OZHQ-ve në fillim të periudhës së Agjendës 2030, dhe janë miratuar disa raporte pasuese që pasqyrojnë progresin e bërë në sektorë të veçantë, përfshirë raportin vullnetar të Shqipërisë për OZHQ-të.

Institucionet e vendit kanë bashkëpunuar për identifikimin e treguesve globalë të monitorimit të OZHQ-ve që janë të matshëm në Shqipëri dhe që përbëjnë një bazë të mirë për sistemin e monitorimit dhe vendosjes së objektivave të SKZHI-III. Lidhja midis prioriteteve strategjike të vendit, të përfshira në këtë strategji, dhe OZHQ të Agjendës 2030, shtjellohet në detaje sipas sektorëve përkatës për çdo shtyllë të SKZHI 2030.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm dhe ka krijuar një kornizë të fortë institucionale dhe strategjike për të përmbushur objektivat e Agjendës 2030. Këto përpjekje përfshijnë integrimin e OZHQ-ve në politikat kombëtare, monitorimin dhe vlerësimin e progresit, dhe angazhimin për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët e saj.

## Kosova dhe Axhenda 2030<sup>2</sup>

Kosova është plotësisht e angazhuar për zbatimin e Agjendës 2030. Ajo ka përgatitur Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030 (SKZH 2030), e cila përcakton qëllimet zhvillimore dhe strategjike të Kosovës deri në vitin 2030. Ajo përmban një analizë të plotë të gjendjes sociale dhe ekonomike të vendit dhe identifikon nevojat dhe sfidat që duhet të adresohen për të bërë ndryshimet e nevojshme deri në vitin 2030. Zbatimi i këtij vizioni ndihmon në përmbushjen e kërkesave për anëtarësim në strukturat Euro-Atlantike dhe përkushtimin për zbatimin dhe integrimin e OZHQ-ve.

Gjithashtu Plani Kombëtar i Zhvillimit (PKZH) përmban masa strategjike, tregues dhe veprime specifike për tre vitet e ardhshme. Kjo perspektivë është e lidhur me planifikimin buxhetor afatmesëm, duke siguruar mbështetje financiare për qëllimet e synuara. Ajo konkretizon dhe i jep prioritetet mbi reformat dhe investimet që përmenden në SKZH 2030 si drejtime të përgjithshme përmes qëllimeve zhvillimore dhe treguesve të ndikimit.

---

<sup>1</sup> [https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK\\_538\\_Draft-Strategjia-Kombetare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf](https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_538_Draft-Strategjia-Kombetare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf)

<sup>2</sup> [https://indep.info/wp-content/uploads/2020/12/INDEP\\_Agenda-2030-in-Kosovo-ALB.pdf](https://indep.info/wp-content/uploads/2020/12/INDEP_Agenda-2030-in-Kosovo-ALB.pdf)  
<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/06032023-Strategjia-dhe-Plani-Kombetare-per-Zhvillim-2030.pdf>

Ky plan është hartuar duke ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, që përfshin të gjithë sektorët e politikave publike dhe agjendat horizontale relevante, të mbledhura rreth katër grupe temash, të quajtura shtyllat e zhvillimit:

I. Rritja e qëndrueshme ekonomike: Kjo përfshin përmirësimin e ekonomisë dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

II. Zhvillimi i barabartë njerëzor: Kjo përfshin përmirësimin e arsimit, shëndetësisë dhe mundësive për të gjithë qytetarët.

III. Siguria dhe sundimi i ligjit: Kjo përfshin përmirësimin e sigurisë publike dhe forcimin e sistemit të drejtësisë.

IV. Qeverisja e mirë: Kjo përfshin përmirësimin e funksionimit të qeverisë dhe luftën kundër korrupsionit.

Kështu, PKZH synon të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke e bërë vendin më të fortë dhe më të përgatitur për të ardhmen.



# MATERIAL TEORIK RRETH OZHQ 6: UJI I PASTËR DHE

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm

## 6

### Ujë i pastër dhe kanalizime

Sigurimi i aksesit në furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjithë.




## KANALIZIMET

**Objektivi 6: Sigurimi i furnizimit dhe i menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë**

### Informacion i përgjithshëm mbi OZHQ 6

Uji është shumë i veçantë për planetin tonë. Ai është i lehtë për t'u shitur dhe përdorur, dhe shumë njerëz kanë interesa ekonomike dhe sociale për të.

Uji i jep jetë planetit tonë. Ai është në lëvizje të vazhdueshme, nga Toka në atmosferë dhe përsëri në Tokë, një cikël i njohur si cikli hidrogjik. Cilësia e ujit ka një rëndësi jetike për njerëzit dhe qeniet e tjera të gjalla. Aktivitetet njerëzore janë shkaku kryesor i ndotjes së ujit dhe në këtë mënyrë ndikojnë tek mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm të mirë dhe cilësor.



Sasia totale e ujit në Tokë është vlerësuar të jetë rreth **1,390 milion km<sup>3</sup>**, ndërsa 97.4% e kësaj sasive është e kripur e ndodhet në dete e oqeanë. Sipas ekspertëve, sasia e ujit të ëmbël është vlerësuar të jetë rreth 2.6 %. Megjithatë, 80% e kësaj sasive uji të ëmbël nuk mund të përdoret sepse ai ndodhet në formë të akullit në akullnaja dhe në majat me borë të përhershme të maleve të lartë. Pjesa tjetër gjendet në liqene, rezervuare, lumenj, përrenj si dhe burime. Vetëm rreth **0.001** përqind e burimeve të ujit janë të ripërtëritshme dhe janë burime ujore që mund të përdoret për t'u pirë dhe për plotësimin e nevojave jetike.<sup>3</sup>

Sot, më shumë se 2 miliardë njerëz në botë nuk kanë ujë të pijshëm. Numri i vendeve që nuk kanë ujë të pastër po rritet. Problemet me furnizimin me

<sup>3</sup> <https://www.unwater.org/publications/un-world-water-development-report-2024>

ujë ndikojnë shumë vende në çdo kontinent. Kjo pengon përdorimin e burimeve natyrore dhe zhvillimin social dhe ekonomik.

### Disa fakte mbi rëndësinë e ujit për jetën

1. Uji mund të gjendet në lumenj, liqene, pellgje, kafshë, bimë, si dhe nën tokë.
2. Njerëzit duhet të pinë rreth dy litra ujë në ditë për të mbajtur temperaturën e trupit në nivele të rregullta.
3. Kur shumica e substancave kalojnë nga gjendja e lëngët në atë të ngurtë, ato bëhen më të rënda dhe më të mëdha në vëllim. Uji, kur ngrin dhe bëhet akull, rrit vëllimin e tij, por bëhet më i lehtë në peshë. Kjo është e rëndësishme për të mbajtur jetën në lumenj dhe liqene gjatë dimrit.
4. Gazrat e atmosferës mund të treten lehtësisht në pikat e ujit të shiut. Kështu, kur uji i shiut mbërrin në Tokë, ai ndikon në cilësinë e tokës, të liqeneve dhe lumenjve.
5. Uji mund të ruajë shumë energji, duke i bërë oqeanet, detet dhe liqenet rezervuare të mëdha nxehtësie. Kjo ndikon në klimën e zonave afër këtyre ujërave dhe është e rëndësishme për proceset kimike që përdorin nxehtësinë.
6. Forca e tensionit sipërfaqësor mat forcat që veprojnë mbi sipërfaqen e ujit. Tërheqja midis molekulave të ujit krijon një shtresë të fortë. Kjo lejon që uji të mbajë mbi sipërfaqen e tij substanca më të rënda dhe me dendësi më të madhe se vetë uji. Disa insekte, si merimangat e ujit, mund të ecin mbi ujë falë këtij tensioni sipërfaqësor.
7. Tensioni sipërfaqësor i ujit është i rëndësishëm për transferimin e energjisë së erës që krijon valët. Valët ndihmojnë për përhapjen e oksigjenit në liqene dhe dete.
8. Kur molekulat e ujit ngjiten me molekulat e xhamit në një tub të hollë, ato tërheqin lart molekulat e tjera të ujit. Ky proces quhet "veprim kapilar" dhe lejon që një sfungjer të thithë ujin e derdhur. Pa këtë cilësi, lëndët ushqyese të nevojshme për bimët do të mbeteshin në tokë.

## Cikli hidrologjik



Uji është gjithmonë në lëvizje midis Tokës dhe atmosferës. Dielli dhe era mundësojnë avullimin e tij nga toka, nga gjethet e bimëve dhe kafshët, nga sipërfaqet e lumenjve, liqeneve dhe oqeanëve. Procesi që e kthen ujin nga gjendja e lëngët në të gaztë quhet avullim. Avujt e ujit nën ndikimin e disa kushteve të caktuara atmosferike do të rikthehen në tokë në formën e shiut ose të borës. Reshjet gjithmonë do të përfundojnë në përrenj apo lumenj, duke transportuar gjatë lëvizjeve të tyre edhe materiale të tjera, dukuri që njihet me emrin shpëlarje e tokës. Reshjet e shiut mbushin lumenjtë dhe liqenet. Lumenjtë derdhen më pas në dete. Disa reshje kalojnë në tokë dhe formojnë ujërat nëntokësore.

### Cilësia e ujit

Ndotja e ujit të pijshëm me mikroorganizma mund të shkaktojë shumë sëmundje, si Hepatiti A, diarreja, salmoneloza dhe shigeloza. Përqendrimet e larta të arsenikut në ujë mund të shkaktojnë probleme serioze shëndetësore, si kanceri i lëkurës. Mungesa e oksigjenit, që vjen nga ndotja me mbetje organike ose nga prania e nitrateve dhe fosfateve në ujë, mund të shkaktojë ngordhjen e peshqve dhe të formave të tjera të jetës ujore.

### Ndotja e ujit

Ka disa lloje ndotësish që ndikojnë në cilësinë e ujit. Ja disa prej tyre:

#### 1. Bakteret dhe viruset

Këto janë mikroorganizma që futen në ujë nga kanalizimet dhe mbeturinat. Ato mund të shkaktojnë shumë sëmundje, dhe çdo ditë vdesin rreth 14,000 njerëz në mbarë botën nga këto sëmundje, gjysma prej tyre fëmijë.

#### 2. Mbetjet organike

Këto janë lëndë që shpërbëhen nga bakteret dhe përdorin oksigjenin në ujë. Kur ka shumë

mbetje organike, uji mbetet pa oksigjen dhe peshqit dhe organizmat e tjerë që kanë nevojë për oksigjen mund të ngordhin.

### 3. Kimikatet e rrezikshme

Këtu përfshihen acide, baza dhe metale toksike si plumbi dhe mercuri. Kur këto substanca janë në përqendrim të lartë, uji bëhet i rrezikshëm për t'u pirë dhe dëmton peshqit dhe organizmat e tjerë ujorë.

### 4. Ushqyesit e bimëve

Nitratet dhe fosfatet që treten në ujë mund të shkaktojnë rritje të tepërt të algave. Kur këto bimë kalben, ato konsumojnë oksigjenin në ujë, duke rrezikuar peshqit. Njerëzit që pinë ujë me shumë nitrate mund të kenë probleme shëndetësore.

### 5. Lëndët kimike

Këto përfshijnë vajrat, naftën, plastikën, pesticidet dhe detergjentët. Ato janë të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe jetën ujore. Burimet kryesore të kësaj ndotjeje janë industria dhe aktivitetet shtëpiake.

### 6. Sedimentet

Grimcat e dheut (tokës) që qëndrojnë pezull në ujë quhen sedimente. Ato turbullojnë ujin dhe pengojnë fotosintezën, duke dëmtuar jetën ujore.

Këto ndotës ndotin ujin dhe e bëjnë të rrezikshëm për t'u pirë dhe për jetën e gjallesave në ujë.

## Burimet e ujit

Burimet ujore përfshijnë **ujërat sipërfaqësore** të cilat janë burime të ripërtëritshme ujore dhe **burimet ujore nëntokësore** që rinovohen shumë ngadalë.

**Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore** janë elemente shumë të rëndësishme të ciklit hidrologjik të Tokës. Ujërat sipërfaqësore përfshijnë lumenjtë, liqenet dhe akullnajat. Në shumë vende evropiane regjimi i rrjedhjes së lumenjve është ndikuar fuqishëm nga veprimtaritë e njeriut, të tilla si krijimi i baseneve ujëmbledhës dhe liqeneve artificiale. Në Evropën Jugore shumë prej lumenjve thahen gjatë stinës së verës. Ujërat sipërfaqësore janë burimet kryesore të ujit që përdoren në Evropë – duke zënë 70 përqind të vlerës mesatare të sasisë së ujit të përdorur.

Ujërat nëntokësorë mbliidhen kryesisht në formacionet ujëmbajtëse, të cilat përbëhen prej shkëmbinjsh të përshkueshëm nga uji, siç mund të jenë rëra, zhavorret dhe balta.

Karakteristikat kryesore të sistemeve të ujërave nëntokësore janë që ato janë të padukshme dhe relativisht të paarritshme, kanë rrjedhje të pakta, janë të qëndrueshme për një kohë të gjatë, kanë reagime të ulëta ndaj ndryshimeve në sipërfaqe.

Në përgjithësi, Evropa nuk ka probleme me mungesën e ujit. Megjithatë, uji i përdorshëm nuk është i shpërndarë njësoj në gjithë kontinentin. Shumë shtete evropiane varen nga burimet ujore të lumenjve që kalojnë përmes disa vendeve për të plotësuar nevojat e tyre për ujë.

Për të arritur Objektivin 6 për ujë të pastër e kanalizime do të duhet të arrihen treguesit e synuar të këtij objekti. Po çfarë kërkojnë të arrijnë këto tregues? Cili është synimi i tyre specifik?

## Treguesi synuar 6.1

Treguesi i synuar 6.1 kërkon që deri në vitin 2030, të arrihet furnizimi i gjithanshëm dhe i barabartë me ujë të pijshëm të sigurt dhe të përbalueshëm për të gjithë;

Thënë ky objektiv më thjeshtë: *Sa është përqindja e popullsisë që përdorin shërbime të ujit të pijshëm të sigurt. Burimet e përshtatshme të ujit të pijshëm përfshijnë: ujin që vjen në banesë nga ujësjellësit, ujin në oborrin e shtëpisë; çezmat publike; uji i paketuar etj.*


## Po pse ky synim:

Sipas raporteve dhe vlerësimeve të bëra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara mund të themi që sot në botë kemi:

- Një në 10 vetë nuk furnizohet me ujë të pijshëm të sigurt.
- Sot, 91 përqind e popullsisë në nivel global përdor burime të sigurta uji të pijshëm, në krahasim me 76 përqind në vitin 1990.
- Në vitin 2021 rreth 663 milionë njerëz kanë përdorur burime jo të sigurta ose ujëra sipërfaqësore.
- Ka një ndryshim midis zonave rurale dhe urbane - **96 përqind e popullsisë globale urbane** përdorin burime të sigurta uji të pijshëm, në krahasim me **84 përqind të popullsisë në zona rurale**. Tetë nga 10 vetë që nuk kanë burime të sigurta uji të pijshëm jetojnë në zonat rurale.

Grafiku më poshtë tregon situatën në Shqipëri mbi këtë tregues, sipas të dhënave të INSTAT<sup>4</sup> deri në vitin 2020.

Përqindja e popullsisë që furnizohet me ujë të pijshëm në familje



## Treguesi synuar 6.2

Treguesi 6.2 është një hap i madh drejt një bote më të pastër dhe më të shëndetshme për të gjithë. Duke siguruar që të gjithë të kenë tualete të pastra dhe sisteme të sigurta kanalizimi.

### Pse është e rëndësishme?

Kur nuk kemi tualete të pastra dhe për ujërat e ndotura derdhen në rrugë e mjedise të hapura, kjo mund çojë në përhapjen e sëmundjeve. Kjo është veçanërisht e rrezikshme për gratë, vajzat dhe personat që janë në gjendje të vështirë, sepse ata mund të jenë më delikatë dhe të pambrojtur ndaj këtyre sëmundjeve.


### Çfarë mund të bëjmë ne?

<sup>4</sup>[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

Ne mund të ndihmojmë duke mësuar më shumë për rëndësinë e higjienës. Mund të kujdesemi që të mbajmë tualetet e pastra dhe të përdorim ujin me kujdes.

Grafiku më poshtë tregon situatën në Shqipëri mbi këtë tregues, sipas të dhënave të Institutit të Statistikave (INSTAT)<sup>5</sup> deri në vitin 2020

Përqindja e popullsisë me tualet brenda familjes



## Treguesi synuar 6.3

Treguesi 6.3 synon të krijojë një botë ku uji është i pastër dhe i sigurt për të gjithë.

### **Pse është i rëndësishëm ky tregues?**

Ndotja e ujit ndodh kur ujërat e zeza dhe të ndotura derdhen në mjediset ujore pa asnjë trajtim. Kjo ndikon negativisht në të gjithë biosferën si tek bimët dhe organizmat që jetojnë në këto sipërfaqe ujore. Në shumë vende, ndotja e ujit është shkaku kryesor i vdekjes dhe sëmundjeve.

### **Si ndotet uji?**

Uji quhet i ndotur kur përmban ndotës që dëmtojnë shëndetin e njeriut, është i papërshtatshëm për përdorim, ose nuk mund të mbështesë jetën e llojeve ujore si peshqit. Fenomene natyrore si vullkanet, stuhitë dhe tërmetet mund të shkaktojnë ndryshime në cilësinë e ujit, por ndotja nga veprimtaritë njerëzore është problemi më i madh.

### **Trajtimi i ujërave të zeza**

Trajtimi i ujërave të zeza është procesi i pastrimit të ujërave të përdorura. Ky proces pastron ujin në mënyrë që të mund të rikthehet në ciklin normal të ujit pa ndotur mjedisin ose të ripërdoret në proceset teknologjike. Kjo është zakonisht përgjegjësi e autoriteteve publike që menaxhojnë mbetjet e ngurta, trajtimin e ujërave të zeza dhe kanalizimet.

### **Çfarë mund të bëjmë ne?**

Edhe pse kjo është një sfidë globale, ne mund të ndihmojmë duke bërë kujdes me mënyrën se si përdorim dhe hedhim mbetjet. Ne mund të mësojmë për rëndësinë e riciklimit dhe të përdorim produkte më pak të dëmshme për mjedisin.

## Treguesi synuar 6.4

Treguesi 6.4 është një pjesë e një plani që synon të sigurojë që ne të përdorim ujin në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme në të gjitha fushat deri në vitin 2030. Ky tregues është shumë i rëndësishëm sepse ndihmon në adresimin e mungesës së ujit dhe siguron që të gjithë të kenë ujë të pijshëm të sigurt.

<sup>5</sup>[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

Treguesi 6.4 ka për qëllim të:

- Rritë ndjeshëm përdorimin efikas të ujit në të gjithë sektorët;
- Sigurojë tërheqjen e qëndrueshme të ujit;
- Sigurojë furnizimin me ujë të pijshëm për të adresuar mungesën e ujit;
- Zvogëlojë ndjeshëm numrin e njerëzve që vuajnë nga mungesa e ujit;

### Përdorimi i Burimeve Ujore

Uji përdoret në shumë mënyra të ndryshme, si për bujqësi, industri dhe përdorim shtëpiak:

- Bujqësia: Uji përdoret për vaditje për të rritur bimët dhe për të ushqyer bagëtinë.
- Industria: Uji përdoret në prodhimin e mallrave dhe si agjent ngrohës ose ftohës në procese të ndryshme industriale.
- Përdorimi shtëpiak : Uji përdoret për të pirë, për higjienë personale, larje dhe zbavitje.

Në Evropë, 53% e ujërave sipërfaqësorë dhe atyre nëntokësorë përdoret në industri, ndërsa vetëm 19% e ujit përdoret për përdorim shtëpiak. Kjo tregon se sa shumë ndryshon përdorimi i ujit në sektorët e ndryshëm të ekonomisë në vende të ndryshme.


### Parashikimet për të Ardhmen

- Pritet të rritet frekuenca e thatësirave dhe të zgjerohet harta e territoreve me mungesë uji, veçanërisht në rajonin e Mesdheut.
- Valët e të nxehtit do të zvogëlojnë sasinë e oksigjenit të tretur në ujërat e lumenjve, duke ndikuar negativisht në jetën ujore.
- Do të rrisin sasinë e ndotësve që derdhen në ujëra, duke ndikuar në cilësinë e ujit në zonat urbane dhe bujqësore.
- Mund të rrisin humbjen e tokës së punueshme dhe elementëve të saj ushqyes, duke ndikuar në prodhimin bujqësor.

### Çfarë mund të bëjmë ne?

Ne mund të ndihmojmë duke përdorur ujin në mënyrë më efikase dhe duke kursyer ujin në jetën e përditshme. Kjo mund të përfshijë përdorimin e pajisjeve që kursejnë ujë, si rubinetet dhe tualetet me efikasitet të lartë, dhe duke ripërdorur ujin kur është e mundur.

	Si e përdorim ujin në shtëpi	%
1	për t'u pirë dhe për gatim	3%
2	për higjienën personale të përditshme:	7%
3	për të bërë banjë (dush):	37%
4	për të larë rrobat:	17%
5	për të larë pjatat	5%
6	uji që shkarkohet në tualet	21%
7	për pastrimin e shtëpisë	5%
8	për aktivitete të tjera	5%



### Treguesi synuar 6.5

Treguesi 6.5 ndihmon në koordinimin e veprimeve për të menaxhuar më mirë ujin dhe burimet ujore.



## Pse është e rëndësishme Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore?

Për të kuptuar më mirë termin dhe çfarë përfshihet në Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore duhet të kini parasysh tre parime kryesore:

1. Barazia sociale: Të sigurohet qasje e barabartë në sasi dhe cilësi të ujit për të gjithë përdoruesit për të ruajtur mirëqenien njerëzore.
2. Eficienca ekonomike: Të rriten përfitimet për një numër sa më të madh përdoruesish me burimet e disponueshme financiare dhe ujore.
3. Qëndrueshmëria ekologjike: Të njihen ekosistemet ujore si përdorues dhe të bëhet ndarja e përshtatshme e burimeve ujore për të mbështetur funksionimin natyror të këtyre ekosistemeve.

### Çfarë mund të bëjmë ne?

Ne mund të ndihmojmë duke mbështetur përpjekjet për menaxhimin e ujit në mënyrë të qëndrueshme. Kjo përfshin përdorimin efikas të ujit në shtëpi dhe në bujqësi, mbështetjen e politikave që promovojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes së ujit.

## Objektivi 6 në Shqipëri dhe Kosovë:


### Shqipëria

Shqipëria ka përditësuar Strategjinë kombëtare për shërbimet e Furnizimit me ujë të pijshëm dhe Kanalizime 2016-2030, me qëllim sigurimin e qëndrueshëm dhe të sigurt dhe me tarifa të përbalueshme nga të gjithë konsumatorët për këto shërbime jetike.

Kështu furnizimi me ujë të pijshëm në vitin 2021 i afrohej 95 % të popullsisë në zonën urbane, në vitin 2030 do të jetë 99%, ndërsa ky shërbim për zonat rurale në vitin 2021 ishte 52 % në vitin 2030 do të jetë 90%.

Shërbimi i grumbullit, largimit e trajtimit të ujërave të zeza që në vitin 2021 i afrohej 75 % të popullsisë në zonën urbane, në vitin 2030 do të jetë 99%, ndërsa ky shërbim për zonat rurale në vitin 2021 ishte 25 % në vitin 2030 do të jetë 75%.

Përqindja e popullsisë që furnizohet me ujë të pijshëm në familje



Qytetet si Korça, Pogradeci, Librazhdi, kanë furnizim 24 orë me ujë me cilësi dhe pa ndërprerje, si dhe kanalizime e trajtim sipas standardeve evropiane. Ndërkohë ka programe zhvillimi që lidhen me ngritjen e impianteve të pastrimit të ujërave të zeza dhe në qytete të tjera si Gjirokastra, Saranda, Fieri, Lezha, Durrësi, Tirana etj.




Duke i konsideruar këto shërbime si prioritet, qeveria shqiptare ka rritur ndjeshëm përpjekjet për një reformim të këtij sektori duke synuar dhe rritjen e investimeve.

## Kosova<sup>6</sup>

Sipas të dhënave në dispozicion nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përqindja e popullsisë që përdor shërbime të ujit të pijshëm të menaxhuar në mënyrë të sigurt është rritur dukshëm nga 63.96% sa ishte në vitin 2011 në 86.31% në vitin 2018, por siç mund të shihet në tabelën më poshtë, kjo përqindje është ulur në vitin 2018 nëse krahasohet me 3 vitet paraprake. Shërbimet e ujit të pijshëm të menaxhuar në mënyrë të sigurt ishte në nivelin më të lartë në vitin 2016 me 89.59%. Kjo tregon se në Kosovë kemi rreth 15% të popullsisë nuk ka qasje në ujë të pastër.

Ekonomite familjare të kyçura në rrjetin e ujësjesit publik, 2011-2022 (%)



Përqindja e ujërave të ndotura të trajtuara në mënyrë të sigurt është shumë e ulët në Kosovë. Sipas të dhënave zyrtare vetëm 1.7% e ujërave të ndotura trajtohen, kurse në të gjitha vendet e zhvilluara trajtimi bëhet për më shumë se 90% të ujërave të ndotura.

<sup>6</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Ujërave në Kosovë: <https://ask.rks-gov.net/media/5366/statistiakt-e-ujit-20182019.pdf> dhe <https://ask.rks-gov.net/media/5366/statistiakt-e-ujit-20182019.pdf>



# Aktivite

# OZHQ 6

## Aktiviteti 1: Ne jemi ujë

**Përshkrimi:** Quiz dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale

**Kohëzgjatja:** 30 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen vlerat e përqindjet për secilin nxënës

### Procedura:

1. Filloni aktivitetin duke shpjeguar nevojën e trupit tonë për ujë.

*Është e thjeshtë, nëse nuk pimë ujë, kjo do të ndikojë në trupin tonë. Trupi i njeriut përbëhet kryesisht nga uji. Uji është lëndë ushqyese më e rëndësishme e trupit dhe është i përfshirë në çdo funksion trupor, duke përbërë 70 – 75% të peshës totale trupore ndaj është kaq e rëndësishme të pini sasinë e nevojshme të ujit çdo ditë.*

2. A e keni pyetur veten sa përqind është ujë në trurin tonë, gjakun, zemrën apo dhe kockat tona.

3. Si mendoni? Plotësoni tabelën më poshtë:

Organi	Sipas mendimit tuaj
1 Truri	?
2 Gjaku	?
3 Zemra	
4 Kockat	
5 Muskujt	
6 Mëlçia	
7 Veshkat	

4. Më pas shfaqni figurën më poshtë e cila tregon përqindjen e ujit që ndodhet në këto organe.



A jeni ndopak të çuditur? Pra pse uji është thelbësor për trupin tuaj? Diskutoni dhe plotësoni informacionin e dhënë më poshtë:

*Duke mos pirë ujë, ne mund të shkaktojmë shumë probleme. Uji na ndihmon të mbajmë dhe rregullojmë temperaturën e trupit tonë. Ai ndihmon në metabolizmin e yndyrave të trupit, ndihmon në tretjen e ushqimit dhe largon të gjitha toksinat e padëshiruara dhe të këqija nga trupi. Thënia që thotë, se uji shërben si sistem transporti në trupin tonë na bën të kuptojmë që kur jeni të dehidratuar gjërat nuk mund të qarkullojnë ashtu siç janë menduar në trup. A e dini se dehidrimi gjithashtu mund të çojë në një rritje të kolesterolit në gjak pasi gjaku bëhet*

*më i trashë, kjo rezulton në vështirësi të qarkullimit të gjakut duke krijuar presionin të lartë gjaku. Kjo është mënyra sesi trupi minimizon humbjen e ujit nga qelizat në trupit.*

## Aktiviteti 2: Uji ndryshon gjithçka

---

**Përshkrimi:** Shfaqje video dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale

**Kohëzgjatja:** Koha e sugjeruar për aktivitetin është 25 minuta

**Materialet:** Video projektor, kompjuter, internet,

Linku i videos: <https://www.youtube.com/watch?v=BCHhëxvQqyg>

### Procedura:

1. Shihni së bashku me nxënësit videon “Uji ndryshon gjithçka” dhe diskutoni:

- -Cilat vende të planetit janë më të ndikuara nga mungesa e ujit të pijshëm?
- -Përmendni arsyet sipas të cilave uji i pastër ndikon në jetën e njeriut (shëndet, edukim, sigurinë e ushqimit)
- -Si e marrin ujin e pijshëm njerëzit në vendet ku sasia e ujit është e pamjaftueshme? Kush janë grupet më të rrezikuara në këtë rast?
- -Çfarë mundësish kemi për të zgjidhur mungesën e ujit të pijshëm?

2. A ka akoma rajone pa ujësjellës dhe ujë të pijshëm në vendin tuaj?

## Aktiviteti 3: Cilin ujë do të zgjidhni ju

---

**Përshkrimi:** Debat dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë në grupe

**Kohëzgjatja:** Koha e sugjeruar për aktivitetin është 25 minuta

**Materialet:** Video projektor, kompjuter, internet,

Linku i videos: <https://www.youtube.com/watch?v=BCHhëxvQqyg>

### Procedura:

1. Ndani pjesëmarrësit në dy grupe.

2. Grupi I ka për detyrë të mbrojë hipotezën që “Uji nga çezmat është më i lirë dhe më i sigurt për t’u përdorur”. Grupi II ka për detyrë të sjellë argumente se “Uji i blerë në shishe dhe i paketuar është më i shëndetshëm”.

3. Informoni nxënësit rreth faktit se njerëzve po iu ofrohet mundësia e zgjedhjes së disa llojeve të ujit të pijshëm. Shumë njerëz përdorin filtra, sterilizues UV, filtra nano, me shkëmbim jonesh, etj. për pastrimin e tij, ndërsa të tjerë pijnë vetëm ujë në shishe.

A është ky një kurth marketingu për të shpenzuar më shumë para, apo ka vërtetë dallim në cilësinë dhe sigurinë e këtyre ujit si një burim jetik dhe i domosdoshëm për një jetë cilësore.

*Aktiviteti mund të vijojë me...*

4. Nxënësit kërkojnë përgjigjen e pyetjeve më lart në etiketat e shisheve të ujit, apo dhe faqe të internetit ku laboratorët që testojnë cilësinë e mostrave të ndryshme të ujit, prezantojnë parametrat e ujit të pijshëm. Zbuloni nëse uji nga sistemi i ujësjellësit që furnizon banesën tuaj përmbush cilësinë që përcaktojnë standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

5. Ju mund të organizoni vizitën e një grupi nxënësish në laboratorin ku ekspertët japin përgjigje dhe zgjidhin dilemat.

6. Pas vizitës nxënësit duhet t'i publikojnë gjetjet në postera ose prezantime, që të informojnë edhe nxënësit e tjerë.

## Aktiviteti 4: Mungesa e ujit, higjienës dhe ndikimi i tyre

---

**Përshkrimi:** Shfaqje video dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë në grupe

**Kohëzgjatja:** Koha e sugjeruar për aktivitetin është 25 minuta

**Materialet:** Video projektor, kompjuter, internet,

Linku i videos: <https://www.youtube.com/ëatch?v=BCHhëxvQqyg>

### Procedura:

1. Ndiq me nxënësit videon “Mungesa e ujit, higjienës dhe ndikimi i tyre në ushqyerjen” dhe diskutoni rreth:

*Mungesës së higjienës dhe kanalizimeve në zonat rurale që ndikon në cilësinë mikrobiologjike të ujit, ndërkohë që higjiena dhe siguria e ujit të pijshëm që vjen nga rrjeti është një nga kushtet kryesore për shëndetin të mirë.*

*- Pse mungesa e tualeteve është e rrezikshme për shëndetin, sidomos atë të fëmijëve?*

*- Çfarë masash parandaluese dhe veprimesh duhen ndërmarrë (nga individët dhe komuniteti) më qëllim përmirësimin e gjendjes?*

*- Çfarë pasojash kanë për shëndetin e fëmijëve, episodet e shpeshta të diarresë?*

## Aktiviteti 5: Loja e Dilemës së ujit

---

**Përshkrimi:** Mendim kritik dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë në grupe

**Kohëzgjatja:** Koha e sugjeruar për aktivitetin është 25 minuta

**Materialet:** Video projektor, kompjuter, internet,

Linku i videos: <https://www.youtube.com/ëatch?v=BCHhëxvQqyg>

### Procedura:

1. Shpjegoju nxënësve se: *nevoja në rritje për trajtimin e ujërave të ndotur në vendbanime të vogla, të cilat në shumicën e rasteve nuk i kanë ujërat e zeza të lidhura me sistemin e trajtimit të ujërave, ka sjellë zhvillimin e teknologjisë së trajtimit biologjik të ujit – përmes ndërtimit të lagunave sanitare artificiale. Këto ‘impiante’ janë sisteme biologjike komplekse, të projektuara për të imituar proceset natyrore që ndodhin në laguna, në kushte të kontrolluara. Impiantet lagunore përthithin ndotjen nga uji, duke e pastruar këtë të fundit.*

2. Propozoj një ekosistem të caktuar të rajonit tënd, që dëshiron ta analizosh, përta i përket trajtimit të ujërave të ndotur (analizo të gjitha veçoritë, çfarë presioni ushtrohet mbi ekosistem, cili është ndotësi më i madh, karakteristikat biologjike dhe klimatike të terrenit etj.). Nxiti debat duke drejtuar pyetjen: Cili sistem trajtimi është më i mirë: sistemi lagunor, apo sistemi konvencional i trajtimit?

3. Përdor faktet e mëposhtme për t'i ardhur në ndihmë debatit:

- Lagunat sanitare përdorin teknologji të thjeshta dhe me kosto të ulët të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së tyre; Nëse ato janë me rrjedhje nëntokësore, nuk kanë as erë të keqe apo insekte. Lagunat varen nga faktorët klimatikë. Sedimentet që krijohen nga precipitimi dhe degradimi biologjik duhet të pastrohen rregullisht. Nuk ka zgjidhje universale për ndërtimin e tyre, pasi ato varen nga karakteristikat gjeomorfologjike, hidrologjike, klimatike dhe biologjike të terrenit dhe ujërat e trajtuar nuk kanë gjithnjë të njëjtën përbërje. Megjithëse sistemi eliminon turbullirën, trajtimi i yndyrave, detergjenteve, baktereve fekale dhe i ndotësve të tjerë nuk arrihet me të njëjtin sukses si në rastin e sistemeve konvencionale të trajtimit.

- Sistemi konvencional zë më pak hapësirë dhe mund të përdoret për kategori më të gjera të ujërave të ndotur. Ato nuk varen nga kushtet klimatike dhe janë rezistente ndaj ndikimeve të jashtme, procesi është i automatizuar, teknologjia e ndërtimit të tyre është e kushtueshme, kostot për mirëmbajtjen dhe ndërrimin e filtrave janë të larta, llumi i tyre duhet çuar në vend depozitime të veçanta, përdorimi i klorit dhe ozonit për dezinfektimin e ujit në njërin nga fazat çliron nën-produkte toksike, por kapaciteti i trajtimit është i lartë.

Do të ishte mirë që tema e debatit të njoftohej më parë, që t'u jepej mundësia nxënësve të përgatiteshin dhe të kërkonin më shumë informacion për lagunat sanitare.

## Aktiviteti 6: Uji i shiut

**Përshkrimi:** Mendim kritik dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë në grupe

**Kohëzgjatja:** Koha e sugjeruar për aktivitetin është 25 minuta

**Materialet:** Video projektor, kompjuter, internet

### Procedura:

1. Informo nxënësit mbi efektin mjedisor dhe financiar që ka grumbullimi dhe përdorimi i ujit të shiut.

*Kjo metodë mund të përdoret njësoj gjithandej (në mjedisin rural dhe urban, në banesat individuale dhe në blloqet e apartamenteve, në kulmet e çative, e deri tek hapësirat publike); zbatohet teknologji pa kosto të larta, si për shoqëritë e pasura edhe ato të varfra.*

2. Nxit nxënësit të shkëmbejnë ide lidhur me përdorimin e ujit të shiut dhe përfitimet që vijnë nga përdorimi i tij.

*Disa ide mund të jenë:*

- përfitimi ekonomik (është falas)
- kursimi i burimeve ujore
- zvogëlohet vartësia nga rrjeti urban i furnizimit me ujë
- përdoret për larjen e tualeteve, të rrobave, makinave dhe rrugëve,
- ka cilësi shumë më të mirë (fortësi, pH, temperaturë), është shumë më i mirë se ai i rrjetit, për të ujitur bimët
- mund të mos jetë i pastër, për shkak të ndotjes së atmosferës, jashtëqitjeve të zogjve apo kafshëve, por pas dezinfektimit të duhur, mund të përdoret për t'u pirë .

3. Pas shkëmbimit të ideve, nxënësve u jepet detyra të bëjnë një kërkim rreth temës: grumbullimi, përdorimi filtrimi dhe pastrimi i ujit të shiut.

4. Gjetjet e kërkimit duhen paraqitur në formën e prezantimit.

## Aktiviteti 7: Menaxhimi i integruar i Burimeve Ujore

---

**Përshkrimi:** Shfaqje video dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë në grupe

**Kohëzgjatja:** Koha e sugjeruar për aktivitetin është 45 minuta

**Materialet:** Video projektor, kompjuter, internet,

Linku i videos: <https://www.youtube.com/ëatch?v=e1tpOB79HnU>

### Procedura:

Shfaq videon “Menaxhimi i integruar i Burimeve Ujore” dhe diskutoni rreth pyetjeve si më poshtë:

- Përse po merr gjithnjë e më tepër rëndësi nevoja për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore?
- Çfarë duhet të bëjmë për të menaxhuar burimet ujore në mënyrë të integruar?
- A realizohet menaxhimi i integruar në vendin tonë – jep mendimin tënd.

## Aktiviteti 8: Lojë me role

---

**Përshkrimi:** Lojë me role

**Pjesëmarrësit:** Punë në grupe

**Kohëzgjatja:** Koha e sugjeruar për aktivitetin është 45 minuta

**Materialet:** Video projektor, kompjuter, internet

### Procedura:

1. Paraqit situatën më poshtë tek nxënësit:

Në kufirin mes dy shteteve gjendet një liqen: gjysma e liqenit i takon territorit të vendit tonë dhe gjysma tjetër territorit të vendit tjetër. Përgjatë bregut gjenden vendbanime që u përkasin të dyja vendeve, ndërsa disa pjesë të bregut kanë natyrën e paprekur. Vendet vendosin të investojnë për zhvillimin e zonës duke zbatuar në mënyrë të përpiktë menaxhimin e integruar të burimeve ujore, meqenëse liqeni ka një status të veçantë mbrojtje në të dyja vendet.

2. Organizo lojë në role:

- Ministrat e dy vendeve që mbulojnë sektorin e ujërave – kanë për detyrë të hartojnë një program për zhvillimin e zonës. Ata e paraqesin programin para klasës (poster, prezantim me gojë)
- Përfaqësuesit e OJF-ve mjedisore (2 përfaqësues) – janë të pranishëm në vendimmarrje përmes diskutimeve/vlerësimit, nëse projektet e paraqitura nga ministria janë të pranueshme në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së liqenit.
- Përfaqësuesit e biznesit, të cilët kanë interes të investojnë në projektin zhvillimor (2 përfaqësues) – janë të pranishëm në vendimmarrje me diskutime mbi kosto efektshmërinë e projekteve të propozuara nga Ministritë, sipas këndvështrimit të tyre.
- Përfaqësues të komunitetit lokal (2 përfaqësues) – janë të pranishëm në proces për të diskutuar nëse sipas këndvështrimit të tyre, projektet e propozuara nga ministrat janë të pranueshme.



3. Jepu rreth 30 minuta kohë nxënësve që të përgatiten për organizimin e lojës me role, me qëllim që t'u jepet kohe "ministrave" të përgatisin një plan zhvillimor.

2. Pas lojës në role pyeti nxënësit se çfarë mendojnë për programin e paraqitur dhe pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë? Arrini në konkluzionin se menaxhimi i integruar është shumë kompleks dhe i vështirë, që t'i kënaqë të gjitha palët.

Më pas lexoju nxënësve shembullin e Lumit Aisne, France që është model pozitiv i menaxhimit të integruar.



Lumi Aisne ishte simbol i natyrës së paprekur dhe gjallesave të botës së egër, veçanërisht në atë pjesë ku rrjedha ngadalësohet. Ndërhyrjet intensive të njeriut sollën një ndryshim tërësor të ekosistemit dhe zhdukjen e biodiversitetit. Për zgjidhjen e këtij problemi dhe mbrojtjen e natyrës, u krijua një strukturë rajonale që kishte lidhje me bashkitë. Me qëllim që të promovohet partneriteti dhe nevoja për të mbrojtur lumin tek publiku i gjerë, rrjeti i sapo krijuar i partnerëve, së bashku me

shoqatat mjedisore organizuan një veprimtari masive pastrimi. Aktivitetit iu bashkuan 600 vullnetarë, të cilët arritën të grumbullonin 12 tonë mbetje. Aktiviteti u promovua gjerësisht në media. Struktura rajonale që kishte si mision mbrojtjen e natyrës mbështeti kryerjen e disa studimeve në fushën hidrologjike dhe atë të mjedisit. Bazuar në rezultatet e marra, u hartua strategjia për mbrojtjen e lumit, ku çdo partner kontribuon me pjesën e tij/saj. Pjesa më e vështirë e marrëveshjes për zbatimin e strategjisë ishte ndryshimi i planeve zhvillimore të ndërtimit për aktivitetet fitimprurëse që ishin miratuar në atë zonë.



# MATERIAL TEORIK RRETH OZHQ 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME



**Objektivi 11. Ndërtimi i qyteteve dhe i vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të sigurt, me aftësi përshtatëse dhe të qëndrueshme**

Objektivi 11 ka shtatë tregues të synuar:

**11.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet për të gjithë njerëzit akses në strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përballueshëm dhe në shërbime bazë dhe të përmirësohet situata në lagjet e varfra.**

**11.2 Deri në vitin 2030, të sigurohet për të gjithë akses në sistemet e transportit të sigurt, të përballueshëm, të arritshëm dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar sigurinë rrugore, sidomos duke zgjeruar shërbimin e transportit publik, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të personave në gjendje të pambrojtur, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.**

**11.3 Deri në vitin 2030, të zgjerohet urbanizimi në nivel gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe të forcohen kapacitetet për planifikimin dhe menaxhimin e vendbanimeve të qëndrueshme, përfshirëse dhe pjesëmarrëse, në të gjitha vendet.**

**11.4 Të forcohen përpjekjet për të mbrojtur dhe për të ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës.**

**11.5 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe numri i njerëzve të prekur nga fatkeqësitë dhe të ulen ndjeshëm humbjet ekonomike të drejtpërdrejta, lidhur me prodhimin e brendshëm bruto në nivel global, të shkaktuara nga fatkeqësitë, përfshirë dhe fatkeqësitë që lidhen me ujin, me fokus mbrojtjen e shtresave të varfra dhe të njerëzve në gjendje të pambrojtur.**

**11.6 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndikimi negativ në mjedis për frymë i qyteteve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera.**

**11.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e gjithanshme në hapësirat publike të gjelbra, të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të arritshme, në veçanti për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.**

## Informacion i përgjithshëm mbi OZHQ 11

Qytetet janë qendra të ideve, tregtisë, kulturës, shkencës, produktivitetit, zhvillimit social dhe shumë më tepër. Qytetet kanë mundësuar që njerëzit të zhvillohen në aspektet sociale dhe ekonomike.

### A e dini se?

- Gjysma e njerëzve në botë, jetojnë në qytete.
- Deri në vitin 2030, pothuajse 60% e njerëzve do të jetojnë në qytete.
- 828 milionë njerëz jetojnë në lagje shumë të varfra dhe ky numër po rritet.
- Qytetet zënë vetëm 3% të sipërfaqes së tokës, por përdorin 60-80% të energjisë dhe shkaktojnë 75% të ndotjes me karbon.
- Urbanizimi i shpejtë po rrit presionin mbi furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimet, mjedisin dhe shëndetin publik.
- Qytetet e mëdha mund të krijojnë më shumë eficiencë dhe risi duke përdorur më pak burime dhe energji.

Megjithatë, ekzistojnë shumë sfida për mirëmbajtjen e qyteteve. Sfidat urbane përfshijnë trafikun, mungesën e fondeve për të siguruar shërbimet komunitare bazë, mungesa e strehimit të përshtatshëm, dhe infrastruktura e papërshtatshme.

Sfidat me të cilat përballen qytetet mund të tejkalohen me mënyra që i lejon ata të vazhdojnë të lulëzojnë dhe rriten, duke përmirësuar përdorimin e burimeve dhe zvogëluar ndotjen dhe varfërinë. E ardhmja që ne duam përfshin qytete që ofrojnë mundësi për të gjithë, me qasje në shërbimet themelore komunitare, energji, strehim, transport dhe më shumë.

Për të arritur Objektivin 11 për qytete dhe komunitete të qëndrueshme do të duhet të arrihen treguesit e synuar të tij. Po çfarë kërkojnë të arrijnë këto tregues? Cili është synimi i tyre specifik?

## Treguesi synuar 11.1

Treguesi i parë kërkon të sigurojë për të gjithë njerëzit strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përbalueshëm ku janë të përfshira të gjitha shërbime bazë, drita, ujë, energji, duke përmirësuar situatën në lagjet e varfra.

### Çfarë kuptojmë me të drejtë për strehim të përshtatshëm?

E drejta për strehim të përshtatshëm është një e drejtë ekonomike, sociale dhe kulturore. Ajo është njohur në kushtetutë dhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, ku thuhet:

*"Çdo njeri ka të drejtë për një nivel jetese të mirë për shëndetin dhe mirëqenien e vetvetes dhe familjes, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet sociale të nevojshme."*

Po sot në botë ka shumë lagje që janë tepër të varfra. Përgjithësisht lagjet e varfra janë zona të mbipopulluara, të cilave u mungojnë shërbimet e sigurta të higjienës sanitare, furnizimi me ujë të pastër, energjia elektrike si dhe shumë shërbime të tjera bazë.

A e keni pyetur ndonjëherë veten pse dhe si krijohen këto lagje të varfra?

Shumë njerëz lëvizin në qytete sepse mendojnë se aty ka më shumë mundësi për punë, shkolla më të mira dhe të ardhura më të larta. Megjithatë, disa prej tyre nuk gjejnë punë menjëherë për shkak të mungesës së aftësive ose tregut të vështirë të punës. Kjo sjell vështirësi financiare dhe ata përfundojnë në lagje të varfra, të cilat janë më të lira në çmime meqë shumë prej shërbimeve mungojnë dhe cilësia e materialeve është shumë e dobët.

Çfarë duhet bërë për të përmirësuar lagjet e varfra?

- Ndërtimi i banesave që njerëzit mund t'i përballojnë financiarisht.
- Sigurimi i ujit të pastër, energjisë elektrike dhe kanalizimeve të sigurta.
- Ndhurma sociale për njerëzit që të fitojnë aftësi të reja për të gjetur punë më të mira.
- Planifikimi më i mirë i qyteteve për të shmangur mbipopullimin dhe për të krijuar hapësira të sigurta dhe të shëndetshme për të gjithë.

Duke përmirësuar strehimin dhe shërbimet bazë, ne mund të krijojmë një botë më të mirë dhe më të drejtë për të gjithë.

## Treguesi synuar 11.2

Treguesi 11.2 kërkon që deri në vitin 2030, të sigurohet për të gjithë njerëzit qasje në sisteme transporti që janë të sigurt, të përbalueshëm, të arritshëm dhe të qëndrueshëm.

### Çfarë është Transporti i Qëndrueshëm?

Transporti i qëndrueshëm është një koncept që lidhet me zhvillimin e qëndrueshëm dhe përshkruan mënyrat dhe sistemet e transportit që janë miqësore me mjedisin dhe shoqërinë. Sipas Këshillit të Bashkimit Evropian të Ministrave të Transportit, transporti i qëndrueshëm ka disa karakteristika kryesore:

1. Transporti i qëndrueshëm siguron që të gjithë individët, kompanitë dhe shoqëria të kenë qasje të sigurt dhe të shëndetshme për zhvillim, duke promovuar barazinë midis brezave.
2. Ai është një transport i përbalueshëm, ofron zgjedhje të ndryshme të mjeteve të transportit dhe mbështet një ekonomi konkurruese dhe zhvillim të balancuar rajonal.
3. Transporti i qëndrueshëm kufizon shkarkimet dhe mbetjet.
4. Përdor burime të ripërtëritshme energjie.
5. Zvogëlon ndikimet negative si në përdorimin e tokës dhe në zhurmat që mund të krijojë.

Transporti i qëndrueshëm është thelbësor sepse ndihmon në përmirësimin e cilësisë së jetës : Ai siguron që njerëzit të kenë akses në shërbime dhe mundësi zhvillimi pa dëmtuar shëndetin e tyre dhe mjedisin. Zvogëlon emetimet e karbonit dhe ndotjen e ajrit, duke ndihmuar në luftimin e ndryshimeve klimatike. Ofron mundësi të barabarta për të gjithë, duke përfshirë ata që janë në grupe më vulnerabël pa shumë të ardhura financiare.

Sot të gjitha vendet po punojnë shumë në këtë sektor, për ta bërë transportin sa më miqësor me mjedisin duke eliminuar ndikimet e tij negative. Drejtimit në të cilat po punohet lidhen me zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve të transportit publik për të bërë më të lehtë dhe më të sigurt për të gjithë përdoruesit. Marrja e masave për të përmirësuar sigurinë në rrugë, si

ndërtimi i trotuareve dhe vendosja e semaforëve. Përdorimi i teknologjisë së gjelbër duke promovuar përdorimin e mjeteve të transportit që përdorin energji të pastër, apo biçikletat dhe makinat elektrike. Gjithmonë e më shumë po punohet që planifikimi i qyteteve të bëhet në mënyrë të tillë që të sigurojë qasje të lehtë dhe të sigurta në shërbimet e transportit për të gjithë banorët.

## Treguesi synuar 11.3

Treguesi 11.3 kërkon një urbanizim të qëndrueshëm të qyteteve që siguron një cilësi të mirë jetese për të gjithë banorët, duke ruajtur mjedisin dhe duke menaxhuar burimet në mënyrë efikase.

- Mbi 70% e njerëzve në Evropë jetojnë në qytete dhe pritet që deri në vitin 2030, kjo shifër të rritet në 80%.
- Qytetet në Evropën Perëndimore janë më të urbanizuara se ato në Evropën Lindore, por Evropa Lindore pritet të përfjetojë një rritje të shpejtë të urbanizimit në dekadat e ardhshme.

Urbanizimi i shpejtë shkakton shumë sfida të cilat do të duhen të zgjidhen. Sfidat kryesore lidhen me: shëndetin publik, zhurmat, hapësirat e gjelbra, cilësinë e ajrit etj.

Politikat e sotme të urbanizimit kërkojnë qasje sistematike dhe bashkëpunim midis sektorëve të ndryshëm për krijimin e qyteteve që ofrojnë strehim të përballeshëm, infrastrukturë të mirë dhe shërbime bazë për të gjithë banorët. Bashkëpunim midis planifikuesve urbanë, ekspertëve të mjedisit, energjisë dhe shëndetit publik për të krijuar qytete miqësore me natyrën dhe njerëzit. Veçanërisht e rëndësishme është planifikimi për të ruajtur dhe zgjeruar hapësirat e gjelbra në qytete si një indikator i rëndësishëm për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe jetës.

## Treguesi synuar 11.4

Treguesi 11.4 njihet si treguesi i synuar i trashëgimisë sonë. Ai kërkon që deri në vitin 2030, të forcohen përpjekjet për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës. Trashëgimia kulturore dhe natyrore është shumë e rëndësishme për të gjithë ne. Ne do të duhet të punojmë së bashku për ta ruajtur dhe mbrojtur atë, në mënyrë që brezat e ardhshëm të mund të mësojnë dhe të gëzojnë këto pasuri.

### Çfarë është Trashëgimia Kulturore?

- Trashëgimia kulturore përfshin gjëra të vlefshme që njerëzit kanë krijuar ose ndërtuar:
- Monumentet : Ndërtesa historike, piktura dhe skulptura të rëndësishme, mbishkrime dhe banesa në shpella.
- Grupet e ndërtesave : Grupi i ndërtesave që kanë vlerë të madhe historike dhe artistike.
- Zonat turistike : Vende të krijuara

### Çfarë është Trashëgimia Natyrore?

- Trashëgimia natyrore përfshin veçori të natyrës që kanë vlerë të madhe:
- Veçori natyrore : Formacione fizike dhe biologjike që janë shumë të veçanta.
- Formacione gjeologjike dhe fizike : Zona ku jetojnë kafshë dhe bimë të rralla.
- Vende natyrore : Vende që janë shumë të bukura ose të rëndësishme për

Pse është e rëndësishme të ruajmë Trashëgiminë?

Trashëgimia kulturore dhe natyrore është një pasuri kombëtare dhe globale. Është e rëndësishme për historinë, kulturën dhe natyrën tonë. Ruajtja e tyre na ndihmon të mësojmë për të kaluarën dhe të mbrojmë planetin tonë për të ardhmen.

### Çfarë mund të bëjmë për të ndihmuar?

- ✚ Të kujdesemi për monumentet dhe natyrën
- ✚ Të mbrojmë ndërtesat historike dhe natyrën nga dëmtimet.
- ✚ Të mësojmë dhe të edukojmë të tjerët.
- ✚ Të mësojmë për historinë dhe natyrën dhe t'i tregojmë të tjerëve rëndësinë e tyre.
- ✚ Të mbështesim projektet që punojnë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

## Vlerat unike shqiptare që i bashkohen trashëgimisë botërore

Butrinti, Gjirokastra dhe Berati janë ndër pasuritë kulturore mijëravjeçare të Shqipërisë që mbajnë “pasaportën” e UNESCO-s, Organizatës për Edukim, Shkencë dhe Kulturë të Kombeve të Bashkuara, ku vendi ynë aderon që prej vitit 1958.

Pranimi në listën e trashëgimisë botërore kulturore të mbrojtur dhe promovuar nga UNESCO, për këto destinacione përkthehet në angazhim por edhe në fonde të veçanta për ruajtjen të paprekur të pasurisë që ato mbartin dhe për ta shndërruar atë në një produkt për turizmin kulturor.

Butrinti është shpallur Monument Kulture në vitin 1948, ndërsa është vlerësuar si pasuri e trashëgimisë së njerëzimit dhe mbrohet nga UNESCO që nga viti 1992.

Ndërsa Berati dhe Gjirokastra janë të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si një sit i vetëm, për shkak të ngjashmërive që këto qytete paraqesin jo vetëm nga ana arkitekturore, por sidomos nga ana kulturore e historike. Ato kanë të njëjtat vlera të jashtëzakonshme universale dhe si të tilla janë konsideruar si një. Gjirokastra, qyteti i gurtë, është regjistruar në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në vitin 2005, ndërsa Berati i është bashkuar kësaj liste në vitin 2008.

## Treguesi synuar 11.5

Treguesi 11.5 synon që deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe njerëzve të prekur nga fatkeqësitë apo katastrofat, si dhe të ulen humbjet ekonomike që ato shkaktojnë. Kjo përfshin mbrojtjen e veçantë të njerëzve të varfër dhe të pambrojtur.

Fatkeqësitë janë ngjarje të papritura që mund të jenë natyrore, si tërmetet, përmbytjet, zjarret dhe thatësirat, ose mund të jenë shkaktuar nga njeriu. Këto ngjarje mund të shkaktojnë shumë dëme, të lëndojnë njerëzit dhe të dëmtojnë ekonominë.

Për të zvogëluar rreziqet nga fatkeqësitë, duhet të ndërmarrim disa masa:

1. Të planifikojmë dhe ndërtojmë në mënyrë që të zvogëlojmë rreziqet nga fatkeqësitë.
2. Të informojmë dhe të edukojmë njerëzit për rreziqet dhe si të mbrohen.
3. Të ndërtojmë dhe të forcojmë infrastrukturën për të përballuar fatkeqësitë, si diga dhe kanale kulluese.
4. Të kemi dhe përgatisim plane për reagim të shpejtë dhe efektiv kur ndodh një fatkeqësi.

## Treguesi synuar 11.6

Treguesi 11.6 kërkon që deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndikimi negativ i qyteteve në mjedis, duke përmirësuar cilësinë e ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve.

Ajri i pastër është shumë i rëndësishëm për shëndetin tonë dhe natyrën. Për fat të keq, ndotja e ajrit në zonat urbane nga transporti, fabrikat dhe makinat ka rritur ndjeshëm sëmundshmërinë. Ndotja e ajrit është e lidhur ngushtë me sëmundje të zemrës dhe mushkërive, alergji dhe kancer.

Si të përmirësojmë cilësinë e ajrit?

- Ventilimi i mjediseve të mbyllura: Hapja e dritareve dhe përdorimi i kondicionerëve ndihmojnë në përmirësimin e ajrit të brendshëm.
- Rregulloret për cilësinë e ajrit: Ligjet që ndalojnë ndotjen dhe pirjen e duhanit në vende publike përmirësojnë shëndetin publik.
- Përdorimi i pajisjeve ekologjike për ngrohje dhe gatim

Në qytetet moderne menaxhimi i mbetjeve është një çështje kritike për shëndetin e mjedisit dhe mirëqenien e qytetarëve. Me popullsinë dhe urbanizimin në rritje, sasia e mbetjeve të prodhuara në qytete po rritet ndjeshëm. Nëse një qytet nuk ka një sistem të mirë të menaxhimit të mbetjeve, kjo mund të çojë në shumë probleme, në ndotjen e mjedisit, kërcënime për shëndetin publik, dhe rritjen e kostove për pastrimin dhe largimin e mbetjeve.

Prandaj, qytetet duhet të zhvillojnë strategji të qëndrueshme për të trajtuar dhe reduktuar mbetjet. Kjo përfshin investime në infrastrukturë për riciklim, programet e edukimit për qytetarët për të promovuar sjellje të përgjegjshme ndaj mbetjeve, si dhe përdorimin e teknologjisë moderne për të identifikuar dhe trajtuar mbetjet në mënyrë më efikase. Nëse menaxhimi i mbetjeve është i dobët, ky problem mund të shkaktojë pasoja për mjedisin dhe jetën e përditshme të banorëve. Menaxhimi i mbetjeve është i rëndësishëm për të mbajtur qytetet të pastra dhe të shëndetshme. Aktualisht, në shumë vende, mbetjet nuk menaxhohen mirë dhe riciklimi është shumë i ulët.

### Si të Përmirësojmë Menaxhimin e Mbetjeve?




Për të mbrojtur mjedisin në qytete, duhet të përmirësojmë cilësinë e ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të shëndetshëm për të gjithë. Me përpjekje të përbashkëta, mund të bëjmë qytetet tona më të pastra dhe më të sigurta për të jetuar.

Një sasi e madhe mbetjesh qarkullojnë në burimet ujor, duke krijuar probleme me ndotjen, duke ndikuar në degradimin e zonave të mbrojtura bregdetare dhe ulur aftësinë e tyre ripërtëritëse.

Grafiku i përqindjes së mbetjeve të ngurta urbane të grumbulluara në Shqipëri në vite. (burimi INSTAT)

% e mbetjeve të ngurta urbane të mbledhura dhe depozituara rregullisht



## Treguesi synuar 11.7

Treguesi 11.7 kërkon që deri në vitin 2030, të sigurohet qasje për të gjithë në hapësira publike të gjelbra, të sigurta dhe të arritshme, sidomos për gratë, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

*Hapësirat publike të gjelbra janë shumë të rëndësishme për jetën në qytet. Ato ofrojnë vende për aktivitet fizik, përmirësojnë shëndetin mendor dhe ndihmojnë në krijimin e një komuniteti të fortë dhe të bashkuar. Është e rëndësishme që të gjithë të kenë qasje në këto hapësira, për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të këndshëm për të gjithë banorët e qytetit.*

Hapësirat publike janë zona në qytete ku njerëzit mund të shkojnë për t'u çlodhur, për të bërë sport ose për të kaluar kohë me miqtë dhe familjen. Ato janë mjedise shumë të rëndësishme për të krijuar lidhje me natyrën dhe janë "oazet" e biodiversitetit.

Këto hapësira përfshijnë:

- Parqet e lagjes, qytetit - vende të gjelbra me pemë, lule dhe fusha sportive.
- Lulishtet - zona me bar dhe pemë, si kopshtet e komunitetit por dhe çatitë e gjelbra.
- Rrugët dhe sheshet - zona ku njerëzit mund të ecin dhe të takohen me njëri-tjetrin.

Hapësirat publike të gjelbra janë shumë të rëndësishme për aktivitet fizik dhe inkurajojnë njerëzit të bëjnë sport dhe të qëndrojnë aktivë. Ndihmojnë në përmirësimin e mirëqenies psikologjike duke ofruar vende të qeta për t'u çlodhur, ku njerëzit mund të takohen dhe të bashkëpunojnë. Ofron strehim për shumë specie natyrore që jetojnë në qytete

Është shumë e rëndësishme që hapësirat publike si lulishtet e parqet të frekuentohen nga të gjithë si fëmijët dhe pleqtë pa harruar dhe personat me aftësi të kufizuara. Këto hapësira duhet të jenë të sigurta dhe miqësore për fëmijët që të luajnë dhe të eksplorojnë natyrën. Duhet të jenë vende ku të moshuarit mund të ecin dhe të çlodhen pa vështirësi.





# Aktivitete OZHQ 11



## Aktiviteti 1: Jeta në qytet dhe jeta në fshat

---

**Përshkrimi:** Loja e dilemës dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjues me ngjyra të ndryshme)

### Procedura:

1. Ndaji pjesëmarrësit në 2 grupeve (3-4 nxënës secili): Një grup dëshiron të jetojë në qytet dhe grupi tjetër dëshiron të jetojë në zonë rurale (fshat). Të tjerët do të luajnë rolin e arbitrit.

2. Më pas paraqisni temën e debatit:

*Shumë njerëz vijnë në zonat qytet për një jetesë më të mirë dhe stil jete më tërheqës, akses në shërbime shëndetësore, shkolla më të mira me besimin se standardi i jetesës së familjes do të përmirësohet. Nga ana tjetër, jetesa në zona rurale ofron mundësi të tjera si p.sh hapjen e një biznesi të vogël (në bujqësi, pulari, turizëm etj.) pa shumë konkurrencë, (karakteristikë kryesisht e qyteteve), jetë pa shumë stres, ushqim organik, ajër i pastër, natyrë.*

3. Grupi jetës urbane – Nxënësit paraqesin përparësitë e jetesës në qytet dhe pikat e dobëta që ata mendojnë në lidhje me jetën në fshat (në zonat rurale).

4. Grupi i jetës në fshat – Nxënësit paraqesin gjithë përparësitë e jetës në fshat (zonat rurale) dhe pikat e dobëta që ata mendojnë në lidhje me jetën në qytet.

Përmes debatit, duke përdorur argumente, nxënësit mund të paraqesin pikëpamjet e tyre për çfarë gjykojnë se është më mirë: p.sh *jeta në zonat rurale me punë të sigurt, ajri i pastër, ushqimi organik, apo jeta në qytet, i cili ofron shumë mundësi, por edhe pasiguri njëkohësisht.*

5. Nxënësit e tjerë janë “arbitra”. Ata duhet të votojnë grupin më të mirë dhe më bindës. Ata mund përfshihen në diskutime me komente dhe mendime plotësuese.

## Aktiviteti 2: Transporti i qëndrueshëm

---

**Përshkrimi:** Shfaqje videos dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjues me ngjyra të ndryshme)

Linku videos: <https://www.youtube.com/watch?v=T9j42-V5cr0>

### Procedura:

1. Shfaqni videon “Transporti i qëndrueshëm”.

2. Më pas diskuto me nxënësit në lidhje me transportin në qytetin/vendin tuaj. Pyetjet e mundshme:

- A është trafiku i rënduar problem kur shkoni ose ktheheni nga shkolla/puna?
- Sa njerëz e përdorin biçikletën?
- Transporti publik ka shumë apo pak përdorues?
- A ka qyteti korsi për biçikletat?

3. Diskutoni mbi përfitimet e përdorimit të biçikletës, transportit publik dhe makinës personale.

4. Më pas nxënësit të ndarë në grupe shkruajnë një letër me tre kërkesa për kryetarin e bashkisë, që do të mund të përmirësojë situatën e trafikut në qytet.

## Aktiviteti 3: Qytet i Zgjuar (Qytet Inteligjent)

---

**Përshkrimi:** Shfaqje videos dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 2-3 orë

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjuet me ngjyra të ndryshme)

Linku videos: <https://www.youtube.com/ëatch?v=Br5aJa6MkBc>

### Procedura:

1. Shfaq videon “Çfarë kuptojmë me Qytete të Zgjuar (Smart City)?”.

2. Më pas filloni diskutimin me pyetjen: Çfarë do të thotë “qytet i zgjuar”?

- Çfarë funksionesh janë integruar në “qytetet e zgjuara”?
- Përsa i përket përdorimit të energjisë, ka një tendencë globale në rritje për zhvillimin e qyteteve të zgjuara, ose ndryshe, tërësisht të qëndrueshme në aspektin e energjisë. Çfarë burimesh përdorin qytetet në fjalë?
- Si duhet të jetë një qytet, që të konsiderohet “qytet i zgjuar”?
- Cilat janë përparësitë e Teknologjisë së Informacionit dhe qyteteve të zgjuara?

3. Diskutoni me nxënësit në lidhje me videon e shfaqur, “qytetet e zgjuara”, gjendjen e mjedisit ku banon komuniteti dhe nxit përgjigje për pyetjet:

- A mund të ri-organizohen qytetet dhe të transformohen në “qytete të zgjuara”? Si mund të arrihet kjo?
- A mund ta shndërrojmë qytetin tonë, në “qytet të zgjuar”? Kush duhet të përfshihet në këtë ri-organizim? Shkruani idetë dhe sugjerimet në tabelë.

4. Tashmë që ata kanë parë videon e kanë më shumë informacion do të duhet të ndahen në tre grupe.

- I. Grupi i I-rë (3-4 anëtarë) – Qyteti i Qëndrueshëm – zbulon se qyteti i tyre mund të shndërrohet në qytet të zgjuar, brenda një periudhe të shkurtër kohe. Nxënësit paraqesin përparësitë dhe problematikat që lidhen me gjendjen në qytet dhe cilësinë e jetës. Ata listojë të gjithë faktorët e qyteteve të zgjuara/qëndrueshme dhe të zgjidhjeve që mund të arrihen brenda një periudhe të shkurtër kohe, drejt transformimit të tyre në qytete të qëndrueshme. Ata mund të përdorin flipchart për prezantimet e tyre.*
- II. Grupi i II-të (3-4 anëtarë) – kupton se qyteti i tyre nuk mund të shndërrohet në qytet të zgjuar/qëndrueshëm në kohë të shkurtër dhe paraqet argumentet përkatëse, apo mbron pikëpamjet e tij (në lidhje me vullnetin politik, zonat e gjelbra, kontenierët për ndarjen e mbetjeve në qytet, ndërgjegjësimin e publikut në përgjithësi.*
- III. Grupi i III-të (nxënësit e tjerë) – votojnë grupin që rezulton më bindës në paraqitjen e ideve.*

5. Shpallni grupin fitues.

## Aktiviteti 4: Të njohim dhe vlerësojmë trashëgiminë

---

**Përshkrimi:** Punë kërkimore dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjues me ngjyra të ndryshme), fotografi, kompjuteri, video projektor, etj.

### Procedura:

#### Varianti A

1. Ndaji nxënësit në dy grupe dhe jepu detyrën të identifikojnë monumentet e mbrojtura natyrore (njëri grup) ose monumentet e trashëgimisë kulturore (grupi tjetër) në komunitetin/ qytetin/bashkinë tënde.

- Ju mund të organizoni një vizitë në këto site (vende) së bashku, të bëni foto ose video të shkurtra (duke përdorur telefona celularë).

2. Paraqiti prezantimet para gjithë grupit. Organizoni konkursin për prezantimin më të bukur dhe votoni për të zgjedhur tre videot më të mira. Shpërndani videot në rrjete sociale.

#### Varianti B

1. Ndaji nxënësit në çifte dhe jepu të bëjnë kërkim:

- Të gjejnë informacion për numrin e monumenteve të trashëgimisë kulturore (ndërtesa publike, monumente të shenjta, ura, komplekse ndërtimi) në vendin tonë.
- Të gjejnë informacion lidhur me numrin e zonave arkeologjike të vendit tonë (përshkruaji zonat duke përdorur informacionin dhe fotografitë)

2. Grumbulloni informacionin lidhur me numrin e aseteve kulturore dhe natyrore të vendit që gjenden në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCOs. Informacioni mund të gjendet në faqen e UNESCOs. Zgjidh një apo dy objekte dhe mblidhni të dhëna mbi rëndësinë e tyre (të dhëna historike, etj.). Gjej foto dhe përgatit një prezantim që ta shfaqësh më pas në klasë.

3. Përpiqu të gjesh informacion për zonat e mbrojtura (parqet kombëtare, parqet natyrore, rezervatet natyrore, etj.). Paraqite atë në formën e prezantimit multimedial.

4. Paraqiti prezantimet para gjithë grupit. Organizoni konkursin për prezantimin më të bukur dhe votoni për të zgjedhur 3 videot më të mira.

## Aktiviteti 5: Kompostimi – forma më e efektshme e riciklimit të mbetjeve organike

---

**Përshkrimi:** Punë kërkimore dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjues me ngjyra të ndryshme)

### Procedura:

1. Prezantoni tek pjesëmarrësit këtë tekst si hyrje:

*Mbetjet organike (ushqimore, kopshtaria apo të gjelbra) përbëjnë rreth 50% të mbetjeve të përgjithshme që grumbullohen në territorin e një qyteti. Kompostimi është*

*mënyra më natyrore dhe forma më e vjetër e riciklimit të tyre, duke i përdorur si lëndë e parë për prodhimin e plehut organik të një cilësie të mirë. Procesi i kompostimit është proces i kontrolluar gjatë të cilit mbetjet organike, me ndihmën e mikro-organizmave që jetojnë në tokë (baktere, myqe, gjallesa të vogla) dhe në prani të oksigjenit, kthehen në humus, i cili nuk ka aromë të keqe dhe mund të përdoret si pleh organik. Këtë mund ta bëjë kushdo në mënyrë individuale (në kopshtin apo oborrin e tij), apo kolektive (në vende të përshtatshme për këtë qëllim), si dhe në impiante të mëdha kompostimi.*

2. Më pas prezantoja nxënësve situatën më poshtë:

*Një grup amvisash shtëpiake dhe nxënësish që jetojnë në një bllok pallatesh me rreth 300 banorë propozon organizimin e një veprimtarie pastrimi të oborrit, i cili është i ndotur dhe nuk krijon mundësi për lojëra, socializim, mbjellje pemësh, etj. Përveç kësaj, propozohet krijimi i një vendi për kompostim (përveç vendosjes së gardheve prej druri, dy lisharseve për fëmijë, mbjelljes së luleve, etj.).*

*Meqenëse në bllok banojnë shumë njerëz, ata gjykojnë se ndarja e mbetjeve organike dhe kompostimi shërbejnë jo vetëm për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit për mbetjet, por zvogëlon ndotjen dhe shërben si shembull pozitiv për lagjet e tjera të qytetit.*

3. Ndaji nxënësit në grupe:

- I. Grupi i studentëve të shkencave natyrore – kërkuesit – ata marrin përsipër të bëjnë kompostimin dhe trajtojnë banorët mbi përfitimet.
- II. Grupi i grave shtëpiake – Ato nuk dinë shumë rreth kompostimit, por kanë vullnet për të bashkëpunuar dhe për të bërë diçka të dobishme.
- III. Grupi i banorëve kundër –ata nuk janë të dhënë pas idesë, pasi mendojnë se oborri do të ketë aromë të keqe dhe mendojnë se kompostimi mund të kryhet vetëm në zonat rurale.
- IV. Fëmijët – Ata janë të lumtur për shkak të lisharseve dhe organizimit të oborrit dhe kanë dëshirë të marrin pjesë në këtë nismë.

4. Diskuto rreth përfitimeve në të gjitha aspektet, ku secili grup mund të shpjegojë pikëpamjen e tij.

## Aktiviteti 6: Çatitë e gjelbra

**Përshkrimi:** Lojë me role

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku janë përshkruar rolet që duhet të bëjë secili

### Procedura:

1. Paraqitu nxënësve përparësitë e çatitë të gjelbra:

*Çatitë e gjelbra janë struktura të mbuluara me gjelbërim. Ato rrisin vlerën estetike të objekteve; kanë ndikim pozitiv në përmirësimin e mikroklimës në qytete, zvogëlojnë nivelin e zhurmës, pastrojnë ajrin, ofrojnë strehë për kafshë të ndryshme (si insekte,*

*zogj, gjitarë të vegjël). Çatitë e gjelbra janë një termoizolues i shkëlqyer për banesat. Ato mbajnë nxehtësinë në dimër dhe e freskojnë mjedisin në verë.*

2. Prezantoja nxënësve situatën më poshtë:

*Një godinë disakatësh me tarracë, ka thirrur asamblenë e banorëve për të diskutuar mbi ofertën e autoriteteve vendore për ta transformuar çatinë e tyre në çati të gjelbër.*

3. Shpërndaju rolet që janë përshkruar më poshtë:

- **Banori alergjik ndaj kafshimit të bletës** –Prej shumë kohësh është alergjik ndaj kafshimit të bletës. Reagimet alergjike i shfaqen menjëherë pas kafshimit, me irritim, vështirësi në frymëmarrje. Kur i ndodh kjo, merr taksinë e parë që gjen dhe shkon në urgjencë, ku bën një injeksion. Ai nuk e mbështet idenë e sipërfaqes së gjelbër në majë të çatisë.
- **Mirëmbajtësi i objektit** – është shumë i zënë gjithë kohën, duke riparuar rrjedhjet, pastruar borën, duke u kujdesur për hapësirën e gjelbër para pallatit, organizuar pastrimin e mjediseve të përbashkëta, etj. Tani i duhet të mirëmbajë edhe gjelbërimin në çati dhe ujisë rregullisht lulet. Kështu që përveç 8 orëve punë, do t'i duhet të punojë edhe 2 -3 orë të tjera.
- **Kujdestare për një banor të pallatit**– Ajo i do lulet veçanërisht bimët aromatike. Zonja është e njohur në lagje për vajrat dhe esencat. Kopshti i gjelbër mbi banesën e saj do t'i ofronte më tepër mundësi të përdorte bimët që i nevojiten. Dilema e saj e vetme është - çfarë ndodh nëse çatia shembet për shkak të peshës së madhe dhe në cepa shfaqen myqe/kërpudha. Myqet nuk janë të shëndetshme dhe përhapin një aromë të pakëndshme.
- **Zotëri i moshuar që banon në katin përdhe, i cili adhuron të rrisë lule** – Me kalimin e viteve, ai e ka gjithnjë e më të vështirë të shkojë në parkun pranë dhe të shijojë gjelbërimin. Çatia e gjelbër do të krijojë mundësinë që të ngjitej me ashensor. Atje mund të ftojë fqinjët e tij dhe të luajnë.
- **Aktivist për çështjet e mjedisit dhe kryetari i asamblesë së banorëve** – Ai është përkrahësi më i madh i idesë. Atë e zemëron vizioni egoist i fqinjëve. Të gjithë e dinë që sipërfaqet e gjelbra thithin dyoksidin e karbonit, pastrojnë ajrin dhe ndikojnë në ndryshimet klimatike? Ai nuk është i sigurt sa banorë do të votojnë pro. Duhet të jenë më tepër se gjysma e tyre.
- **Arkitekt i ri** – I sapo diplomuar në universitet, atij po i jepet mundësia të bëjë diçka krijuese. Ai e di që në qytete të mëdha kudo në botë, si Vjenë apo Paris është e njohur ideja e çative të gjelbra, kopshteve apo fermave vertikale. Kjo mund të jetë diçka pozitive për objektin dhe promovimin personal të tij.
- **Mbarështues derrash** – Ai ka në tarracën e objektit plevicën ku mban derrat. Këtë vit derrkucët e tij fituan dy herë kupën e kampionatit në nivel lokal dhe rajonal. Ndërtimi i kopshtit në tarracë do të thotë se derrat e tij do të jenë vetëm kujtime të së shkuarës.
- **Nëna shumë e zënë me punë** – Shumicën e kohës punon në shtëpi. Ajo ka tre fëmijë të vegjël, që kanë nevojë të luajnë. Sipërfaqja e gjelbër para banesës nuk është e përshtatshme, se rruga ndodhet pranë. Çatia e gjelbër u jep fëmijëve mundësinë të luajnë, por a është e sigurt? Përveç kësaj, fëmijët janë gjithë kohës nën diell, gjë që nuk është e mirë për ta.

4. Pas lojës në role **Arbitrat** marrin vendimin: Ndërtimin ose jo të çatisë së gjelbër.

# MATERIAL TEORIK RRETH OZHQ 13: VEPRIMI PËR KLIMËN

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm

# 13

## Veprim për klimën

Ndërmarrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe efektet e tjera.



**Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe efektet e tyre**

## Informacion i përgjithshëm mbi OZHQ 13

### Çfarë është Klima?

Klima është modeli i motit në një vend të caktuar gjatë një periudhe të gjatë kohe. Ndryshe nga moti, i cili mund të ndryshojë çdo ditë, klima është një përmbledhje e kushteve të motit që ndodhin në një zonë për vite me radhë. Klima na tregon si është moti zakonisht në një vend, për shembull, nëse është i ngrohtë dhe i thatë apo i ftohtë dhe me shi.

### Çfarë është Ngruhja Globale?

Ngruhja globale ndodh kur Toka bëhet më e ngrohtë për shkak të gazrave që mbajnë nxehtësinë brenda atmosferës. Këto gaze, si dioksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>) dhe metani, vijnë nga aktivitetet njerëzore si djegia e karburanteve dhe bujqësia.

### Si ndodh Ngruhja Globale?

Dielli dërgon energji në Tokë dhe Toka përdor këtë energji për të ngrohur veten. Një pjesë e kësaj energjie kthehet në hapësirë, por gazrat serrë e bllokojnë këtë nxehtësi dhe e mbajnë brenda atmosferës, duke e bërë Tokën më të ngrohtë, si një batanije që mbështjell planetin.

### Çfarë është Efekti Serrë?

Efekti serrë është një fenomen që ka ekzistuar gjithmonë. Atmosfera e Tokës vepron si një batanije që e mban planetin më të ngrohtë sesa do të ishte pa të. Gazrat serrë në atmosferë, si dioksidi i karbonit dhe metani, e bllokojnë një pjesë të nxehtësisë që Toka kthen në hapësirë.

### Si ndikon aktiviteti njerëzor?

Pas revolucionit industrial, njerëzit filluan të përdorin më shumë makineri dhe fabrika, duke djegur shumë karburante si qymyr dhe naftë. Kjo çliroi një sasi të madhe gazrash në atmosferë, duke përfshirë CO2, metanin, dhe të tjerë. Këto gaze bllokojnë më shumë nxehtësi në atmosferë, duke bërë që temperatura mesatare e Tokës të rritet.

### Ngrohja globale mund të shkaktojë:

- 1. Rritje të temperaturave mesatare në Tokë.
- 1. Thatësira dhe përmytje më të shpeshta.
- 1. Shkrirje të akullnajave dhe rritje të nivelit të detit.
- 1. Ndryshime në mot, si më shumë valë të të nxehtit dhe stuhi të forta.
- 1. Rrezik për shëndetin e njerëzve, për shembull, përhapjen e sëmundjeve.

### Çfarë mund të bëjmë për të ndihmuar?

- ✚ Të përdorim energjinë e rinovueshme, siç është energjia diellore dhe ajo e erës.
- ✚ Të ulim shkarkimet e dioksidit të karbonit dhe gazit metan duke përdorur më pak makinat dhe më shumë transport publik dhe biçikletat.
- ✚ Të riciklojmë dhe të ripërdorim produktet e sendet tonë duke ju zgjatur ciklin e jetës.
- ✚ Të mbjellim pemë dhe lule që ndihmojnë në thithjen e dioksidit të karbonit nga atmosfera.

Ngrohja globale është një problem i madh, por me veprime të vogla nga të gjithë ne, mund të ndihmojmë që planeti ynë të jetë një vend më i mirë për të gjithë.

## Treguesi synuar 13.1

Ndryshimet klimatike sjellin rreziqe të mëdha, duke përfshirë ngjarje ekstreme të motit si valët e të nxehtit, reshjet e mëdha, thatësitat e zgjatura dhe stuhitë. Këto fenomene ndikojnë në furnizimin me ushqim, ujë dhe pijshëm, jetën e egër dhe shëndetin e njerëzve. Kushtet ekstreme të motit gjithashtu mund të dëmtojnë infrastrukturën si rrugët, hekurudhat dhe ndërtesat.

### A e dini se në vitet e ardhshme?

**Rajoni i Mesdheut dhe Europa Juglindore do të preken më shumë nga ngjarjet ekstreme të motit. Në rajonin tonë do të ketë një rritje në frekuencën e valëve të të nxehtit, uljeve të menjëhershme të temperaturave nën zero dhe reshje intensive.**

### Si mund të përgatitemi?

- ✚ Ndërtimi dhe përmirësimi i ndërtesave, rrugëve dhe hekurudhave për t'i bërë më të qëndrueshme ndaj kushteve ekstreme të motit.
- ✚ Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të ujit.
- ✚ Hartimi i planeve të evakuimit dhe përgatitja e komuniteteve për fatkeqësitë natyrore.
- ✚ Edukimi i njerëzve për ndryshimet klimatike dhe mënyrat për të reduktuar ndikimin e tyre.



Ndryshimet klimatike pritet të rrisin numrin dhe intensitetin e ngjarjeve ekstreme të motit në shumë pjesë të botës, përfshirë Evropën. Këto ngjarje, që dallojnë nga kushtet e zakonshme atmosferike, përfshijnë periudha të gjata thatësire, reshje të mëdha shiu që shkaktojnë përmytje, valë të të nxehtit dhe ciklone. Pasoja të këtyre ngjarjeve janë shkatërruese, duke shkaktuar shkatërrime materiale, varfëri, humbje jetësh njerëzore dhe duke kërkuar miliarda euro për rikuperimin dhe rindërtimin e zonave të prekura. Për shembull, në vitin 2013, fatkeqësitë natyrore i kushtuan botës rreth 192 miliardë dollarë amerikanë.

#### Vulnerabiliteti i zonës bregdetare

- Zona bregdetare e Adriatikut në Shqipëri është e sheshtë dhe e ulët, duke e bërë të ndjeshme ndaj rritjes së nivelit të detit dhe përmytjeve.
- Rritja e temperaturave pritet të përshpejtojë valët e të nxehtit dhe të ulë reshjet vjetore deri në -8.5% deri në vitin 2050 dhe deri në -18.1% deri në vitin 2100.
- Rritja e nivelit të detit me rreth 15 cm gjatë shekullit të fundit ka shkakuar tërheqjen e vijës bregdetare.

#### Ndikimi në reshjet dhe disponueshmërinë e ujit

- Ndryshimet klimatike priten të zvogëlojnë reshjet vjetore dhe të rrisin avullimin, duke çuar në pakësimin e rrjedhës së lumenjve.
- Megjithatë, reshjet ekstreme priten të rriten, duke shkakuar përmytje më të shpeshta gjatë

#### Bujqësia dhe ndryshimet klimatike

- Bujqësia është e ndjeshme ndaj ndryshimeve të motit dhe klimës, përfshirë temperaturat dhe reshjet.
- Sasia vjetore e reshjeve efektive është e pamjaftueshme për shumë kultura, duke kërkuar më shumë ujë për ujitje.

#### Ekosistemet dhe biodiversiteti

- Rënia e reshjeve dhe mungesa e ujit do të ndikojnë negativisht në bimësinë dhe biodiversitetin.
- Ligatinat dhe habitatet bregdetare janë të rrezikuara nga ndryshimet klimatike dhe veprat e

#### Turizmi

- Ndryshimet klimatike kanë ndikuar në sektorin e turizmit, me erozionin bregdetar që zhduk qindra metra katrorë plazhe çdo vit.
- Deri në vitin 2030, periudha tetor-maj do të mbetet e papërshtatshme për turizmin e diellit dhe detar, ndërsa periudha tjetër do të ofrojë nivele të plota komoditeti.

#### Shëndeti publik

- Ndryshimet klimatike do të ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e njeriut përmes stresit termik dhe përmytjeve, dhe tërthorazi përmes sëmundjeve të transmetuara nga insektet dhe patogjenët që përhapen nga uji.
- Skenarët parashikojnë një rritje të vdekjeve të lidhura me të nxehtin dhe epidemive të sëmundjeve infektive pas përmytjeve dhe stuhive.
- Grupet më të prekshme janë të moshuarit, fëmijët, të varfrit dhe veçanërisht gratë.

### Ndikimi i ndryshimeve klimatike në zonën bregdetare të Shqipërisë

Përshtatja ndaj këtyre ndryshimeve dhe forcimi i aftësive ripërtëritëse janë kritike për të mbrojtur njerëzit dhe natyrën nga pasojat e rënda të ndryshimeve klimatike. Strategjitë përfshijnë forcimin e infrastrukturës, përdorimin e teknologjive të reja, planifikimin e emergjencave dhe edukimin e popullsisë për të zvogëluar ndikimet negative të ndryshimeve klimatike.

## Treguesi synuar 13.2

Treguesi 13.2 synon që masat për ndryshimet klimatike të përfshijnë politikat, strategjitë dhe planet kombëtare.

### Masat ndërkombëtare për ndryshimet klimatike

Ndryshimet klimatike janë një problem global që kërkon veprim të përbashkët nga të gjitha vendet. Dy masa të rëndësishme ndërkombëtare për të luftuar ndryshimet klimatike janë:

1. Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC): E miratuar në vitin 1992, kjo konventë përfshin përpjekjet e vendeve për të mbledhur dhe ndarë informacion mbi shkarkimet e gazeve serrë dhe për të marrë masa për zvogëlimin e tyre. UNFCCC ka hyrë në fuqi në vitin 1994 dhe është ratifikuar nga 192 vende.
2. Protokollin e Kiotos: I miratuar në vitin 1997 hyri në fuqi që nga viti 2005, ky protokoll detyron vendet të zvogëlojnë shkarkimet e gazeve serrë. Protokollin parashikon tre mekanizma fleksibël për të ndihmuar vendet të arrijnë objektivat e tyre.

## Marrëveshja e Parisit

Në vitin 2015, në Konferencën e Klimës në Paris, 195 vende miratuan Marrëveshjen e Parisit, një marrëveshje universale dhe ligjërisht e detyrueshme për klimën globale. Elementet kryesore të Marrëveshjes së Parisit janë:

- Masat zbutëse (zvogëlimi i shkarkimeve) - Qeveritë synojnë të kufizojnë ngritjen e temperaturës globale nën 2°C dhe të përpiqen për 1.5°C.
- Transparenca dhe aksionet globale - Qeveritë do të mblidhen çdo pesë vjet për të vendosur objektiva më ambicioze dhe do të raportojnë progresin.
- Adaptimi (përshtatja) - Qeveritë do të forcojnë aftësitë për t'u përballur me ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe do të sigurojnë mbështetje për vendet në zhvillim.

## Shqipëria dhe Ndryshimet Klimatike

Shqipëria është palë nënshkruese e Konventës Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC-së) dhe ka ratifikuar Protokollin e Kiotos në vitin 2004. Shqipëria merr pjesë aktivisht në konferencat ndërkombëtare për ndryshimet klimatike dhe ka angazhuar strategji për zvogëlimin e shkarkimeve të gazeve serrë.

Lufta kundër ndryshimeve klimatike kërkon bashkëpunim ndërkombëtar dhe veprime kombëtare të fuqishme. Marrëveshjet si UNFCCC, Protokollin e Kiotos dhe Marrëveshja e Parisit janë hapa të rëndësishëm drejt një të ardhme më të qëndrueshme për planetin tonë. Shqipëria, si pjesë e këtyre marrëveshjeve, angazhohet për të marrë masa për të mbrojtur mjedisin dhe për të zvogëluar ndikimet negative të ndryshimeve klimatike.

## Treguesi synuar 13.3

Treguesi 13.3 ka fokusin tek edukimi dhe ndërgjegjësimi për ndryshimet klimatike

Ky tregues synon të përmirësojë edukimin, ndërgjegjësimin dhe aftësitë për të zbutur ndryshimet klimatike, për t'u përshtatur ndaj tyre, për të zvogëluar ndikimet dhe për paralajmërimin e hershëm.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi janë thelbësore për të kuptuar dhe përballuar ndryshimet klimatike. Të gjithë, nga nxënësit në shkolla deri te udhëheqësit e qeverive, duhet të jenë të informuar për shkaqet dhe efektet e ndryshimeve klimatike. Edukimi ndihmon në:

- Marrjen e vendimeve të informuara: Duke kuptuar shkencën pas ndryshimeve klimatike, njerëzit mund të marrin vendime të bazuara në fakte.
- Zbutjen dhe përshtatjen: Të kuptuarit e ndryshimeve klimatike ndihmon në uljen e ndikimeve dhe përshtatjen ndaj kushteve të reja.

Dy Strategjitë Kryesore ku fokusohet puna në lidhje me veprimin për klimën janë:

1. **Zbutja e ndikimeve** (Masat Zbutëse) e cila përfshin uljen e shkarkimeve të gazeve serrë për të kufizuar ndryshimet klimatike.

2. **Përshtatja ndaj ndryshimeve** e cila nënkupton ndryshimin e sjelljes dhe stilit të jetës për t'u përshtatur me ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Masat Zbutëse	Masat Përshtatëse
<p>Masat zbutëse synojnë të kufizojnë ndikimet e ndryshimeve klimatike duke zvogëluar shkarkimet e gazeve serrë dhe përmirësuar kapacitetin e depozitave të karbonit.</p> <p>Shembuj të masave zbutëse janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdorimi i burimeve të rinovueshme: Si energjia e erës dhe diellit.</li> <li>- Rritja e pyjeve: Pyjet thithin dioksidin e karbonit dhe ndihmojnë në uljen e gazeve serrë.</li> <li>- Eficienca e energjisë: Përdorimi i pajisjeve dhe ndërtesave që konsumojnë më pak energji.</li> </ul>	<p>Masat përshtatëse ndihmojnë në parashikimin dhe zvogëlimin e efekteve negative të ndryshimeve klimatike.</p> <p>Shembuj të masave përshtatëse janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtimi i mureve mbrojtëse: Kundër përmytjeve nga rritja e nivelit të detit.</li> <li>- Përmirësimi i infrastrukturës: Rrugët dhe ndërtesat të jenë më rezistente ndaj kushteve ekstreme të motit.</li> <li>- Ndryshimi i sjelljes: Kursimi i ujit dhe mbjellja e kulturave bujqësore që janë më rezistente ndaj ndryshimeve klimatike.</li> </ul>

Edukimi dhe ndërgjegjësimi për ndryshimet klimatike janë thelbësore për të përballuar sfidat e ardhshme. Duke mësuar dhe vepruar tani, mund të krijojmë një të ardhme më të mirë dhe të qëndrueshme për brezat e ardhshëm. Masat zbutëse dhe përshtatëse ndihmojnë në uljen e ndikimeve negative dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Të gjithë, nga individët te institucionet, duhet të punojnë së bashku për të luftuar ndryshimet klimatike.



# Aktivitete OZHQ 13

## Aktiviteti 1: Zbullo Produktet e Gjelbra

---

**Përshkrimi:** Hulumentim, mendim kritik, kërkim tregu dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 90 minuta

**Materialet:** Produkte që përdoren në përditshmëri, fletë, markera, ngjyra për të krijuar fletëpalosje apo postera.

### Procedura:

1. Bëni një prezantim në lidhje me produktet e gjelbra. Ju mund të thoni që produktet e gjelbra janë ato produkte që janë prodhuar duke përdorur praktika të qëndrueshme dhe kanë ndikim të ulët në mjedis. Këto produkte ndihmojnë në zvogëlimin e gjurmës së karbonit dhe janë shpesh me një cikël të gjatë jete, të riciklueshme ose të bëra nga materiale të ricikluara.
  - Më pas mund të shtroni për diskutim pyetjen:
    - o Pse është e rëndësishme të zgjedhim produkte të gjelbra?
    - o Si ta dallojmë një produkt nëse ai është i gjelbër?
    - o çfarë tiparesh kanë këto lloj produktesh?
2. Hulumentim mbi produktet e gjelbra
  - Secili nxënës të zgjedhë një produkt të përditshëm (p.sh., çantë shkolle, shishe uji, ushqime, veshje). Ai më pas duhet të hulumtojë mbi produktet e gjelbra alternative për atë produkt. Për shembull, një shishe uji e bërë nga qelqi/alumini në vend të plastikës, ose një çantë shkolle e bërë nga materiale të ricikluara.
  - Shkruani disa përfitime të përdorimit të këtij produkti të gjelbër (si reduktimi i mbetjeve plastike, kursimi i energjisë, etj.).
  - Një hulumentim tjetër mund të bëhet mbi etiketat e “gjelbra”, të cilat janë pjesë e etiketës së këtyre lloj produkteve.
3. Krahasimi i Produkteve
  - Krahasoni një produkt të zakonshëm me një produkt të gjelbër (p.sh., një shishe plastike dhe një shishe qelqi).
  - Për secilin produkt, vlerësoni ndikimin e tyre mjedisor, duke përfshirë:
    - o Sasinë e CO2 të çliruar gjatë prodhimit
    - o Jetëgjatësinë e produktit
    - o Mundësitë për riciklim
    - o Diskutoni në grup cilat janë përfitimet dhe disavantazhet e secilit produkt.
4. Krijimi i një Fletë Informuese
  - Çdo nxënës të krijojë një fletë informative (fletëpalosje) për një produkt të gjelbër. Fleta duhet të përfshijë:
    - o Emrin e produktit
    - o Një përshkrim të shkurtër të tij
    - o Përfitimet mjedisore të përdorimit të këtij produkti
    - o Ilustrime ose foto të produktit
  - Shpërndani fletët informuese në klasë dhe diskutoni për to.
5. Promovimi i produkteve të gjelbra në shkollë
  - Organizoni një ditë promovimi ku nxënësit mund të prezantojnë produktet e gjelbra që kanë hulumtuar dhe krijuar fletëpalosje/postera etj.
  - Ftoni nxënësit t'i ndajnë këto informacione me prindërit dhe komunitetin shkollor për të nxitur përdorimin e produkteve të gjelbra.

- Diskutoni në klasë për çfarë kanë mësuar rreth produkteve të gjelbra dhe si mund të bëhen konsumatorë më të qëndrueshëm.
- Nxisni nxënësit të reflektojnë mbi zgjedhjet e tyre të përditshme dhe të mendojnë për mënyra të tjera për të reduktuar gjurmën e tyre të karbonit.

## Aktiviteti 2: Ndikimi i ndryshimeve klimatike në Evropë

---

**Përshkrimi:** Shfaqje video dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale

**Kohëzgjatja:** 30 minuta

**Materialet:** Linku videos: <https://www.youtube.com/ëatch?v=jS0ZIUsQHg>

### Procedura:

Shfaqni videon “Ndikimi i ndryshimeve klimatike në Evropë”. Diskutoni me nxënësit rreth pyetjeve:

- Çfarë ndikimi kanë ndryshimet klimatike në ekosisteme, ekonomi, shëndet, cilësinë e jetës etj., në Evropë?
- Ndaloje videon në 0:23 minuta. Analizo grafikun.
- Sa është rritur temperatura globale nga 1984 në 2020?
- Cilat janë pasojat e ndryshimeve klimatike në Evropë dhe në glob?
- Si ndikojnë ndryshimet klimatike në jetën e egër?
- Ndaloje videon në 0:52 minuta. Analizo hartën e Evropës.
- Cilat pjesë të Evropës janë prekur nga pasojat e përmbytjeve të shpeshta dhe rritjes së temperaturës?
- Si ndikojnë ndryshimet klimatike mbi ekonominë globale?
- A ka pjesë të globit që nuk janë ndikuar nga ndryshimet klimatike?
- Çfarë duhet të bëjmë që të zvogëlojmë efektin e tyre
- Ç’do të thotë termi shoqëri e përgatitur për tu përballur me ndryshimet klimatike?
- Si ndikojnë parqet dhe liqenet e qyteteve në zvogëlimin e pasojave të ndryshimeve klimatike?
- Si e interpretojmë shprehjen ‘Mirëqenia e shoqërisë dhe e ardhmja jonë varen nga çfarë bëjmë tani’?

## Aktiviteti 3: Shkencëtarët dhe skeptikët e klimës

---

**Përshkrimi:** Loja e dilemës

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjues me ngjyra të ndryshme)

### Procedura:

- Prezantoje temën tek nxënësit dhe jepu kohë të përgatiten.
- Prezantoni situatën: Artikujt e gazetave paraqesin se ndryshimet klimatike janë një nga problemet më të ndjeshme të ditës, ndërsa shkencëtarët janë ndarë në dy grupe që debatojnë:
  - njëri që thotë se ngrohja globale është pasojë e neglizhencës shumëvjeçare të njeriut dhe

- tjetri, të ashtuquajturit skeptikët e klimës, besojnë se ndryshimet klimatike janë një çështje e fryrë artificialisht prej njerëzve.

Tek e fundit, secili prej nesh udhëhiqet nga pikëpamjet e veta mbi fenomenet, përfshi ndryshimet klimatike.

- Ndaji nxënësit në tre grupe: “skeptikët e klimës” që besojnë se njeriu **nuk** është përgjegjës për ndryshimet klimatike, shkencëtarët që besojnë të kundërtën (se njeriu është përgjegjës) dhe “arbitrat”
- Organizo debatin mes grupeve. Dy grupet e shkencëtarëve paraqesin pikëpamjet e tyre dhe “arbitrat” votojnë grupin që është më bindës në argumentim.

### **Informacion ndihmës për debatin**

Sipas pikëpamjes së “skeptikëve të klimës”

- Klima ndryshon në mënyrë të vazhdueshme. Shpesh ndryshimet klimatike në planet janë pasojë e fenomeneve të ndryshme natyrore si: – rritja e aktivitetit diellor, shpërthimet vullkanike të nivelit global, ndikimi i forcës tërheqëse të Hënës, etj. Përveç kësaj, sipas shkencëtarit të famshëm Milutin Milanković, “Canon of the Earth’s Insolation”, ngrohja e tanishme e planetit ndjek ftohjen globale (që është karakteristikë e gjithë planetëve të sistemit diellor).
- Kundërshtarët e kësaj teze kërkojnë të përfitojnë fonde për projekte kërkimi. Kjo është një nga argumentet kryesore që paraqiten.
- Ngruhja globale ka qenë e pranishme edhe më parë dhe është pozitive për ekonominë dhe qytetërimin. Periudhat që shoqërohen me rritje të temperaturave i kanë ndihmuar njerëzit përgjatë historisë të krijojnë qytetërime dhe shfrytëzojnë sipërfaqe toke, që nuk janë të aksesueshme (p.sh vendbanimet Vikinge në Groenlandë). Përveç kësaj, shtegu Veriperëndimor (përmes Oqeanit Arktik) nuk ka akuj disa javë në vit, për shkak të ngrohjes globale, e cila ndihmon anijet të shkurtojnë trajektoren e lundrimit (duke sjelle përfitime ekonomike).

Sipas shkencëtarëve që besojnë se njeriu është përgjegjës për ndryshimet klimatike:

- Shkrirja e akujve në Arktik ndodh me shpejtësi të pabesueshme. Akujt vazhdojnë të shkrirë, sidomos në Polin e Veriut. Sikundër Amazona përfaqëson “mushkëritë e planetit”, Arktiku është arteria e tij. Raporti i OKB cilëson se ngrohja globale ka sjellë shkrirjen e akujve rreth Polin të Veriut. Akujt e Arktikut janë shkaktari i ndryshimeve dhe faktori që ndikon në jetën e gjithë planetit.
  - Acidifikimi i oqeanëve si pasojë e rritjes së sasisë së dyoksidit të karbonit.
- Oqeanet janë ‘filtrat’ natyrorë të karbonit, që do të thotë se thithin/largojnë CO2 nga atmosfera. Meqë sasia e CO2 në atmosferë rritet, edhe përqendrimi i tij në oqeanë rritet, duke sjellë acidifikimin e tyre. Kur tejkalohen normat kritike të lejuara, gjendja mund të jetë tejet e rrezikshme për botën e egër.
- Modelet kompjuterike të ndryshimeve klimatike të Planetit janë të sakta dhe të besueshme.



## Aktiviteti 4: Ndryshimet klimatike si “Pikturë e madhe”

---

**Përshkrimi:** Lojë me role, refleksione dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjues me ngjyra të ndryshme)

### Procedura:

Ndryshimet klimatike duhet të shihen si “Pikturë e madhe” për të gjitha nivelet (vendore, rajonale, globale) dhe nga këndvështrimi i të gjitha grupeve shoqërore (individëve, qytetarëve, politikanëve, shkencëtarëve dhe zyrtarëve). Ndryshimet klimatike nuk janë ‘problemi’ i dikujt, prandaj qasja për zgjidhjen e tyre duhet të jetë serioze dhe e përgjegjshme.

Mësuesi përgatit dy grupe letrash për mësimin Ndryshimet Klimatike në “Pikturën e madhe”

- Letrat me profesione: fermerë, organizatorë festivalesh muzikore, punëtor, mjek, lojtar, alpinist, hotelier, pronar restoranti në bregdet, qytetar, pasagjer, pilot, inxhinier mjedisi ...
- Letrat me dukuri të motit që lidhen me ndryshimet klimatike: sasi e shtuar reshjesh, sasi e vogël reshjesh, numër më i madh ditësh me diell në vit, numër më i vogël ditësh me diell në vit, temperatura mesatare të larta gjatë vitit, temperatura ditore më të ulëta gjatë vitit, stuhi të shpeshta, dimra pa reshje, verë pa reshje ...
  - A. Ndaji nxënësit në grupe (me nga dy apo më shumë nxënës);
  - B. Secili grup tërheq dy letra (një letër me profesione dhe një me dukuri moti);
  - C. Jepi disa minuta secilit grup që të bjerë dakord lidhur me ndikimin e mundshëm që ka ndryshimi i dhënë klimatik, ndaj profesionit të dhënë.
  - D. Secili grup prezanton mendimin e tij lidhur me ndikimin që ndryshimi i caktuar klimatik krijon mbi profesionin e dhënë.
  - E. Gjatë lojës me role nxënësit duhet të shfaqin të kuptuarit e duhur në lidhje me kompleksitetin e ndryshimeve klimatike dhe të arrijnë në përfundimet e mëposhtme:
- Ndryshimet klimatike duhen parë si një pikturë e plotë dhe jo nga interesa të ngushtë personale (kushte të caktuara të motit mund të jenë të favorshme për dikë, por mund të shkaktojnë dëme për të tjerë).
- Idetë e ndërsjellta duhet të dëgjohen dhe shkëmbehen, që të mund të gjejnë bashkërisht zgjidhje për zbutjen e ndryshimeve klimatike.

## Aktiviteti 5: Bota pas 30 vitesh

---

**Përshkrimi:** Diskutime

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjues me ngjyra të ndryshme)

### Procedura:

*Imagjinoni si do të dukej bota pas 30 vitesh, e varur ndaj zhvillimit të teknologjisë, shkencës kompjuterike, robotëve, klimatologjisë, gjeo-inxhinierisë, teknologjisë së hapësirës, ku fokusi kryesor të jenë ndryshimet klimatike.*

- a. Ndaji nxënësit në 5 grupe. Jepi secilit grup një letër që të shkruajë idetë e veta.

- b. Pas 25 minutash, të gjitha letrat vendosen në një vend të dukshëm (p.sh. ngjiten në tabelë). Secili grup duhet të qëndrojë pranë letrës dhe të sqarojë idenë.
- c. Në 20 minutat pasuese diskutoni rreth botës dhe klimës në të ardhmen.

## Aktiviteti 6: Sot dhe nesër

---

**Përshkrimi:** Kërkime dhe hulumtime, diskutime

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjues me ngjyra të ndryshme)

### Procedura:

- A. Ndajini nxënësit në tre grupe sipas interesit.
- B. Jepini detyrën në një prej temave të mëposhtme:

- Lagjja ime në të shkuarën dhe të tashmen –Përpiquni të gjeni fotografi të hershme të lagjes (që janë kryesisht foto të monumente fetare, shkollave apo varrezave). Gjeni informacion mbi kohën kur janë bërë fotot. Krahaso pamjen e atëhershme të zonës me pamjen që ka tani. Merrni foto të vendeve, në mënyrë të tillë që dita/muaji i fotove të reja, të përkojë me fotot e vjetra. Krahaso bimësinë në të shkuarën dhe të tashmen. A ekzistojnë lidhje të këtyre gjetjeve dhe ndryshimeve klimatike?
- Dimrat nuk janë më aq të ftohtë sa ç'kanë qenë më parë – Shumica e lumenjve ngrinin gjatë periudhës së dimrit dhe ishte e lehtë të kaloje në anën tjetër të lumit. Sot nuk është më e njëjta situatë, për shkak të temperaturave të larta gjatë dimrit. Përpiqu të gjesh informacion nga Instituti Hidrometeorologjik mbi gjendjen e lumenjve gjatë dimrit, gjatë 100 viteve të fundit (në formë grafiku apo tabelash). A ekzistojnë lidhje të këtyre gjetjeve dhe ndryshimeve klimatike?
- Gjurma ushqimore dhe e karbonit – Zgjedhjet tona ditore në lidhje me ushqimin kanë ndikim në mjedis. Dihet se edhe ndryshimet e vogla në zgjedhjen e ushqimit që blejmë kanë ndikim pozitiv në mjedis, madje edhe në zvogëlimin e shkarkimeve të gazeve serë. Përpiqu të gjeni informacion në literaturë ose internet mbi 'dietën' e gjelbër, me shkarkime të ulëta të CO<sub>2</sub> (gjurma e karbonit), ushqim organik ose me certifikatë që do të thotë se është në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm.

B. Pas kërkimit secili grup paraqet gjetjet para klasës. Nëse nxënësit sjellin fotografi, grafikë, tabela, etj, të vendosen në një vend të dukshëm në korridorin e shkollës, së bashku me disa shpjegime shoqëruese.

## Aktiviteti 8: Kuptojmë Gjurmën e Karbonit

---

**Përshkrimi:** Shfaqje videos dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjues me ngjyra të ndryshme)

Linku aplikacionit të llogaritjes: <https://www.footprintcalculator.org/home>

### Procedura:

1. Fillojmë me shpjegimin e qëllimit të aktivitetit: Të mësojmë se çfarë është gjurma e karbonit dhe si mund ta reduktojmë atë në përditshmërinë tonë.
  - Përkufizojmë dhe shkruajmë në dërrasë: Gjurma e karbonit është sasia totale e dyoksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>) dhe gazrave të tjerë serë që lëshohen në atmosferë nga veprimtaritë e përditshme të njeriut, siç janë transporti, ushqimi, dhe energjia.
  - Diskutim në klasë mbi pyetjen - Pse është e rëndësishme të reduktojmë gjurmën e karbonit?
2. Aktiviteti vijon me Identifikimi i burimeve të shkarkimeve të karbonit
  - Listoni aktivitete të përditshme që kontribuojnë në gjurmën e karbonit (p.sh., përdorimi i makinës, konsumimi i mishit, përdorimi i pajisjeve elektrike).
3. Llogaritja e gjurmës personale të karbonit
  - Për secilin nga aktivitetet e mëposhtme, vlerësoni se sa shpesh i bëni ato (p.sh., sa herë në javë përdorni makinën, sa shpesh hani mish).
  - Përdorni një llogaritës të thjeshtë të gjurmës së karbonit online për të llogaritur kontributin tuaj të përditshëm (mund të përdorni një faqe interneti të sigurt dhe të përshtatshme për fëmijët). <https://www.footprintcalculator.org/home>
4. Reduktimi i gjurmës së karbonit
  - Diskutoni mënyra për të reduktuar gjurmën e karbonit në përditshmëri (p.sh., ecje në vend të makinës, ulja e konsumit të mishit, përdorimi i energjisë së rinovueshme).
  - Përgatitni një plan për një javë ku do të përpiqeni të reduktoni gjurmën tuaj të karbonit. Çdo fëmijë mund të zgjedhë dy ose tre veprime që do të përpiqet të zbatojë.
5. Krijimi i posterit - Krijoni një poster edukativ që tregon çfarë është gjurma e karbonit dhe mënyrat për ta reduktuar atë. Përdorni vizatime, foto dhe shpjegime të thjeshta.

Diskutoni në klasë se çfarë kanë mësuar dhe si ndihen rreth ndryshimeve që kanë bërë për të reduktuar gjurmën e tyre të karbonit.

## Aktiviteti 9: Një konferencë për klimën

**Përshkrimi:** Lojë me role, interpretim faktesh dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjes me ngjyra të ndryshme)

### Procedura:

1. Prezantohuni nxënësve situatën më poshtë:

*Konferenca ku do të propozohen masa për zbutjen e ndryshimeve klimatike, është në fazën përgatitore. Në këto kushte, është me rëndësi miratimi i masave të zbatimit në politikat, strategjitë dhe planet kombëtare.*

*Përveç politikanëve, në konferencë janë ftuar edhe përfaqësues të ndryshëm të grupeve të interesit me qëllim që të shprehin mendimet e tyre, të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të strategjisë kombëtare.*

2. Përgatit 5 fletë letre me tabela të printuara për secilin grup nxënësish dhe etiketa të roleve që do tu ndahen nxënësve (32 fletë dhe 4 etiketa me të njëjtin rol):

- I. **Politikani**– bën vlerësim afatshkurtër të çështjeve, pasi nuk është i sigurt sa kohë do të qëndrojë në skenën politike. Në këndvështrimin e tij për ndryshimet klimatike fokusi është vetëm shmangia rreziqeve.
- II. **Kryetari i Bashkisë** – Parimi kryesor i tij është ruajtja e balancave. Ai kupton se veprimet apo mosveprimet kanë rreziqet e tyre. Kjo është arsyeja përse kur diskutohen ndryshimet klimatike, balanca mes mundësive dhe rreziqeve duhet mbajtur gjithnjë parasysh.
- III. **Përfaqësuesi i OJFsë “Muskëtjerët ekologjikë”** – gjithnjë mendon pozitivisht, vendos objektiva realistë ndaj vetes dhe të tjerëve. Ai kupton se ndryshimet klimatike janë një çështje që kërkon adresim afatgjatë.
- IV. **Drejtori i agjencisë së udhëtimit** – megjithëse ai/ajo është i ndërgjegjshëm se kushtet e mira klimatike janë në favor të zhvillimit të turizmit dhe fitimit të agjencisë, ai/ajo nuk dëshiron të përfshihet. Ai/ajo kupton se objektivat për zvogëlimin e ndryshimeve të klimës duhen harmonizuar.
- V. **Nxënës i shkollës së mesme që shqetësohet për të ardhmen**– ka mësuar dhe është i mirë informuar lidhur me pasojat e mundshme të ngrohjes globale. Ai/ajo beson, me frikë, se ndryshimet klimatike janë të pashmangshme dhe duhet të përshtatemi ndaj kushteve, në të ardhmen.
- VI. **Qytetar i përgjegjshëm**– Megjithëse ka ndjeshmëri ndaj mjedisit ai/ajo mendon se zgjidhja e problemeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike më së shumti varen nga qeveria.
- VII. **Drejtori i impiantit termik** – përfaqëson interesin e biznesit, i cili bllokoi nismat që adresojnë nevojën për t’u dhënë zgjidhje çështjeve të ndryshimeve klimatike. Gjëja që e tremb më tepër është zbatimi i parimit “ndotësi paguan”.
- VIII. **Inxhinieri projektues** – krijues, novator, punëtor, ndërmerr hapa për të ecur para. Ai/ajo beson se stimuli ndaj novacionit dhe përdorimit të burimeve të reja të energjisë, eficienta energjetike, etj duhet të rritet. Sipas tij, projektimi i shtëpive ekologjike ka një rëndësi gjithnjë e më të madhe. Ai/ajo mendon se regjimi i taksave ndaj teknologjive që shkaktajnë rrezatime të dëmshme është shumë i rëndësishëm.

Vizato tabelën në dërrasë:

Masa zbutëse ndaj ndryshimeve klimatike	Zbatimi i masave në nivel politikash dhe strategjish	Planifikim afatgjatë - me projeksione 100 vjeçare të planifikimit paraprak

3. Ndaji nxënësit në 5 grupe. Ftoj nxënësit të tërheqin një etiketë. Ka të ngjarë që dy role të njëjta të bien tek i njëjti grup, kjo gjë rrit mundësinë për konsensus. Secili grup duhet të:

- Propozojë tre masa zbutëse ndaj pasojave të ndryshimeve klimatike
- Paraqesë vizionin e tij mbi zbatimin e masave, përmes strategjive dhe politikave
- Vlerësojë nëse masat e propozuara janë të zbatueshme gjatë viteve pasardhëse.

4. Konferenca drejtohet nga një lehtësues (mësues ose nxënës). Grupeve u jepet 25 minuta kohë për të rënë dakord dhe për të plotësuar tabelën. Lehtësuesi kalon nëpër tryeza për të ndihmuar, nëse nevojitet. Pas kësaj secili grup paraqet zgjidhjet, duke plotësuar vendet përkatëse në tabelën e ndërtuar. Secilit grup i jepet 3 minuta kohë për prezantim.

5. Në pesë minutat e fundit lehtësuesi mbyll konferencën duke bërë komentet përkatëse.

# MATERIAL TEORIK RRETH OZHQ 15: JETA NË

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm

# 15

## Jeta në tokë

Mbrojtja, rimëkëmbja dhe nxitja e shfrytëzimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, pyjeve të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme, luftimi i shkretëtirimit, ndalimi dhe prapësimi i procesit të degradimit të tokës, si dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.



## TOKË

**Objektivi 15. Mbrojtja, rehabilitimi dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër shkretëtirimit, ndalimi e kthimi mbrapa i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit**

### Informacion i përgjithshëm mbi OZHQ 15

Të gjitha qeniet e gjalla të Tokës mund të grupohen në lloje. **Llojet janë grupe organizmesh të ngjashme, që kanë mënyrë të njëjtë jetese e sjelljeje, që kanë përbërje kimike dhe strukturë gjenetike shumë të ngjashme. Organizmat e të njëjtit lloj, që riprodhohen seksualisht, janë të aftë të lënë pasardhës pjellorë.**

Një nga burimet më të rëndësishme dhe të çmuara të Tokës është shumëllojshmëria biologjike e llojeve, e njohur me emrin biodiversitet.

Çdo organizëm i gjallë është në vetvete një burim informacioni gjenetik, i cili lejon atë të përshtatet me ndryshimet e mjedisit ku jeton. Gjatë miliona vjetëve janë shfaqur lloje të reja, ndërsa ato që nuk kanë mundur të përshtaten me ndryshimet, janë zhdukur. Zhdukja e llojeve është një proces natyror. Megjithatë, shpejtësia e këtij procesi është rritur mjaft me zgjerimin dhe zhvillimin e zonave urbane dhe të aktivitetit njerëzor. Ndërhyrja e njeriut në natyrë, përmes shpyllëzimit, ndotjes, ndryshimeve klimatike dhe shfrytëzimit të tepruar të burimeve natyrore, ka kontribuar në përshpejtimin e zhdukjes së llojeve. Ky përshpejtim i zhdukjes ka pasoja serioze për ekosistemet dhe biodiversitetin global, duke kërcënuar stabilitetin ekologjik dhe burimet natyrore nga të cilat varen shumë forma jetese, përfshirë edhe vetë njerëzit.

## Biodiversiteti përbëhet nga tri komponentë:



1. Shumëllojshmëria gjenetike, e cila përfshin tërësinë e individëve brenda të të njëjtit lloj.



2. Shumëllojshmëria e organizmave, që jetojnë sot në Tokë. Kjo shumëllojshmëri përfshin, sipas biologëve, rreth 15 milion deri në 40 milion lloje, megjithëse shkencëtarët kanë mundur të klasifikojnë suksesshëm vetëm



3. Shumëllojshmëria e ekosistemeve, që përfshin tërësinë e zonave pyjore, shkretëtirave, fushave, lumenjve, deteve, oqeanëve dhe të gjitha komunitetet e tjera të botës së gjallë, që ndërveprojnë me njëra-tjetrën, si dhe me mjedisin jo të gjallë.

Ekzistenca e llojeve të ndryshme të pyjeve, kullotave, shkretëtirave dhe ekosistemeve të tjera tokësore dhe të ujërave të ëmbla përcaktohet fillimisht nga ndryshimet e temperaturës mesatare dhe reshjeve, të shkaktuara nga kushtet atmosferike globale. Klima dhe jeta në tokë ndryshon në varësi të gjerësisë gjeografike ashtu dhe të gjatësisë gjeografike.

Ruajtja e formave të ndryshme të jetës në tokë kërkon përpjekje të synuara për të nxitur përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore dhe ekosistemeve të tjera. Objektivi 15 përqendrohet në mënyrë të veçantë në menaxhimin e pyjeve në mënyrë të qëndrueshme; për të ndaluar përmbytjet dhe degradimin natyror të habitateve tokësore; luftimin në mënyrë të suksesshme të shkretëtirëzimit; dhe ndalimin e humbjes së biodiversitetit. Faktet e mëposhtme konfirmojnë nevojën për masa urgjente dhe efektive:

- Rreth viteve 1990 dhe 2020, sipërfaqet e pyjeve në botë janë zvogëluar nga 31.7% e sipërfaqes globale të tokës në 30.7%. Kjo humbje ishte kryesisht për shkak të shndërrimit të sipërfaqeve pyjore për përdorime të tjera, si bujqësi dhe zhvillim të infrastrukturës.
- Në çdo rajon, mbijetesa e llojeve është gjithnjë e më shumë në rrezik. Që nga viti 2020, mbi 23,000 lloje të bimëve, kërpudhave dhe kafshëve përballeshin me një rrezik të lartë të zhdukjes së tyre.
- Tregtia e paligjshme e botës së egër është një fenomen global. Që prej vitit 1999, së paku 7,000 lloje kafshësh dhe bimësh janë raportuar si të tregtuara në mënyrë të paligjshme, në 120 shtete. Trafikimi i botës së egër prek të gjitha rajonet e botës, qofshin ato vendburime, vend transit apo destinacione

Për të arritur Objektivin 15 për jetën në Tokë do të duhet të arrihen treguesit e synuar të tij. Po çfarë kërkojnë të arrijnë këto tregues? Cili është synimi i tyre specifik?





Lumenjtë kryesore: Drini, Buna, Mati, Shkumbini, Semani, Vjosa, Erzeni, Ishmi, Bistrica të cilat kanë një efekt të rëndësishëm në biodiversitetin bregdetar të vendit.

Shqipëria është e pasur në pyje dhe kullota. Afërsisht 60 % ose 244.000 ha të kullotave janë kullota dhe livadhe alpine dhe nën-alpine. Pyjet dhe kullota kanë diversitet të llojeve, të formacioneve, dhe komuniteteve bimore e shtazore.

## Treguesi synuar 15.2

Treguesi 15.2 ka në fokus menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, ndalimin e shpyllëzimit, rehabilitimin e pyjeve të degraduar, rritjen e qëndrueshme e pyllëzimit dhe ripyllëzimin në nivel global.


Pyjet kanë një rëndësi të madhe për jetën e përditshme të njerëzve. Pyjet kanë shumë funksione:

- Kryesisht, ato mbrojnë dhe formojnë burimet natyrore.
- Nëpërmjet procesit të fotosintezës, pyjet ripërtërijnë furnizimin me oksigjen të atmosferës duke thithur CO<sub>2</sub> dhe duke zbutur efektin serrë.
- Pyjet mundësojnë një mjedis për shumë lloje bimësh dhe kafshësh, duke mbrojtur dhe mbështetur shumëllojshmërinë e natyrës.
- Pyjet pastrojnë mjedisin duke zvogëluar zhurmat, erërat e forta, pluhurat e gazet.
- Pyjet ndihmojnë në rregullimin e rrjedhës së ujërave sipërfaqësore, zbutjen e temperaturave të ulëta apo të larta dhe në parandalimin e erozionit të tokës.
- Pyjet stabilizojnë klimën dhe i japin formë peizazhit.
- Pyjet janë zona të njohura për çlodhje dhe argëtim.

## Pyjet e Shqipërisë

Pyjet e Shqipërisë mbulojnë më shumë se 33 % të sipërfaqes totale, me një biodiversitet të lartë drurësh, flore barishtore dhe faune pyjore, i favorizuar nga kushtet morfologjike dhe fitoklimatike të territorit.

Sipërfaqja e pyjeve si % e sipërfaqes totale të tokës



Pyjet shtrihen, pothuajse, në të gjithë territorin e vendit, por më tepër ato pozicionohen në zonën malore dhe kodrinore të vendit, ku përmenden si rrethe të pasura me pyje të larta: Puka, Librazhdi, Korça, Dibra, Shkodra etj.; ndërsa sipërfaqen më të madhe të pyjeve për banorë e kanë: Puka, Tropoja, Kolonja, Mirdita.

## Treguesi synuar 15.3

Treguesi 15.3 synon që deri në vitin 2030, të luftohet shkretëtirëzimi, të rehabilitohet toka e degraduar, përfshirë tokën e prekur nga shkretëtirëzimi, thatësira dhe përmytjet, dhe të ndalet degradimi i tokës.

Po çfarë është shkretëtirëzimi?

Shkretëtirëzimi është procesi i degradimit të tokës ku rajonet e thata bëhen më të thatë dhe humbasin burimet ujore, bimët dhe kafshët. Ky fenomen shkaktohet nga aktivitetet njerëzore dhe disa faktorët fizikë. Shkretëtirëzimi është një problem serioz që ndikon 40% të sipërfaqes së Tokës dhe rreth 1 miliard njerëz në mbi 100 vende. Zonat më të prekura përfshijnë:

- Savanat e Afrikës
- Rrafshnaltat dhe stepat e Amerikës dhe Evropës Lindore
- Zonat e populluara pak në Australi dhe Mesdhe



Cilët janë shkaktarët e shkretëtirëzimit?

- Kullotja e vazhdueshme nga kafshët të cilat mund të shkatërrojnë vegjetacionin.
- Pemët dhe shkurret priten, duke lënë tokën të zhveshur e cila më pas degradon në një tokë të thatë pa jetë.
- Tokat e punuara humbasin strukturën e tyre natyrore dhe bëhen më të ndjeshme ndaj erozionit.

Shkretëtirëzimi ka pasoja negative të cilat çojnë në zvogëlim e pjellorisë së tokës, të papërshtatshme për bujqësi. Shpesh si pasojë e kësaj bimët me vlera ushqimore zëvendësohen nga bimë të pavlefshme. Humbja e mbulesës bimore çon në përmbytje më të shpeshta dhe të rënda. Por shkretëtirëzimi prek zonat e prodhimit të ushqimit dhe rrit varfërinë dhe shkakton probleme të frymëmarrjes dhe alergji tek njerëzit.

Nëse do të duhet të ndihmojmë për të luftuar shkretëtirëzimin, atëherë vëmendja jonë duhet të fokusohet tek mbjellja e pemëve dhe shkurreve për të ndihmuar në rikuperimin e tokës. Në bujqësi duhet të përdorim teknika që mbrojnë dhe ruajnë tokën, ndërtimi i sistemeve të qëndrueshme të ujitjes për të shmangur kripëzimin dhe erozionin e tokës.

*Si është situata në lidhje me shkretëtirëzimin në Shqipëri?*

Sipas Raporteve të gjendjes së Mjedisit, Shqipëria ka një sipërfaqe rreth 100,000 ha tokë bujqësore në Shqipëri që janë në procesin e shkretëtirëzimit. Erozioni i tokës është një problem i madh, ku humbjet vjetore arrijnë deri në 150 ton/ha dhe në disa zona të vendit.

## Treguesi synuar 15.4

Treguesi 15.4 synon që deri në vitin 2030, të sigurohet ruajtja e ekosistemeve malore, përfshirë dhe shumëllojshmërinë biologjike të tyre. Pra ky tregues ka një fokus të veçantë tek malet.

### Çfarë janë malet?

Malet janë formacione gjeologjike të përbëra nga shkëmbinj dhe tokë që ngrihen mbi terrenin përreth. Malet mbulojnë një të pestën e sipërfaqes së Tokës dhe gjenden në 75% të vendeve të botës. Ato janë shtëpia e rreth një të dhjetës së popullsisë së botës dhe burimi i më shumë se gjysmës së ujërave të ëmbla në botë.

A e dini si janë krijuar malet?

Malet formohen nga forcat tektonike dhe aktiviteti vullkanik. Malet vullkanike formohen kur shkëmbi i shkrirë shpërthen nëpër koren e Tokës dhe grumbullohet në sipërfaqe, ose ato

formohen nga ndeshja e pllakave tektonike që i detyron blloqet e shkëmbinjve të ngrihen lart si rezultat i palosjes së kores së tokës.

### **Cila është rëndësia e Ekosistemeve Malore**

- Ekosistemet Malore janë burimi kryesor i ujit për lumenjtë dhe liqenet.
- Klima në malet e larta është më e ftohtë, duke ndikuar në ekosistem dhe biodiversitet.
- Ekosistemet Malore janë shtëpi për shumë lloje bimësh dhe kafshësh që nuk gjenden në vende të tjera në botë.

*Cilat janë shkaqet kryesore që çojnë në dëmtimin e Ekosistemeve Malore*

- Numri i madh i turistëve mund të dëmtojë ekosistemet delikate dhe ekuilibrat ekologjikë në këto habitate.
- Prerja e pyjeve dhe përdorimi i tepruar i mjeteve rrugore që përshkojnë këto ekosisteme duke i fragmentuar në habitate më të vegjël dhe të brishtë.
- Zhvillimi i infrastrukturës për turizëm masiv si sportin e skive dëmton peizazhet dhe habitatet natyrore të maleve.

### **Biodiversiteti malor në Shqipëri**

Biodiversiteti malor në Shqipëri është jashtëzakonisht i larmishëm, përfshirë një gamë të gjerë të florës dhe faunës së egër. Kjo pasuri natyrore është një nga arsyet kryesore për ekzistencën e një numri të konsiderueshëm të Zonave të Mbrojtura malore, të cilat zënë rreth 50% të sipërfaqes së zonave të mbrojtura të vendit.

Disa nga zonat e mbrojtura malore më të rëndësishme në Shqipëri përfshijnë:

- Parku Kombëtar i Alpeve Shqiptare
- Parku Kombëtar i Lurës
- Parku Kombëtar i Malit të Dajtit
- Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli
- Parku Kombëtar Bredhi i Drenovës

Biodiversiteti malor në Shqipëri përbën një pasuri të madhe natyrore që kërkon mbrojtje dhe menaxhim të kujdesshëm. Zonat e mbrojtura malore janë jetësore për ruajtjen e llojeve të rrezikuara dhe habitateve kritike, duke kontribuar në ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe stabilitetit të klimës në rajon dhe më gjerë. Menaxhimi efektiv dhe ruajtja e këtyre zonave janë thelbësore për të siguruar që këto pasuri të ekzistojnë dhe të përmirësohen për gjeneratat e ardhshme.

### **Biodiversiteti malor në Kosovë**

Ndonëse Kosova është një vend i vogël, shquhet për një biodiversitet të pasur. Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur biologjik dhe peizazhi me një llojshmëri të mirë bimëve dhe kafshëve, prani të llojeve relikte, endemike si dhe të llojeve me rëndësi të veçantë.

Zonat malore më të pasura me bimë dhe kafshë janë “Malet e Sharrit” dhe “Bjeshkët e Nemuna”.

## Treguesi synuar 15.5

Treguesi 15.5 kërkon ndërmarrjen e masave urgjente dhe të rëndësishme për të zvogëluar degradimin e habitateve natyrore, ndalimin e humbjes së biodiversitetit dhe, deri në vitin 2020, mbrojtjen dhe parandalimin e zhdukjes së llojeve të kërcënuar.

Zonat Kryesore të Biodiversitetit në Evropë janë Pellgu i Mesdheut, Malet e Kaukazit dhe Karpitet. Studimet e viteve të fundit të bëra nga Agjencia Evropiane e Mbrojtjes së Natyrës tregojnë që biodiversiteti në Evropë vazhdon të pakësohet, duke ndikuar drejtpërdrejt në efikasitetin, produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e ekosistemeve. Kjo duket nga përqindja e llojeve të kërcënuara: p.sh llogaritet që rreth 40% e llojeve të peshqve të ujërave të ëmbla, 23% e llojeve të Amfibëve dhe rreth 2% e bimëve mjekësore në Evropë kanë statusin të kërcënuara.

Presionet kryesore mbi biodiversitetin janë:

1. Degradimi dhe humbja e habitateve natyrore që vjen si pasojë e intensifikimit të bujqësisë, urbanizimi, transformimi i tokës për zhvillime industriale dhe infrastrukturore.
2. Përdorimi i burimeve natyrore përtej kapaciteteve si në sektorët e bujqësisë, pylltaria.
3. Peshkimi masiv dhe me mjete që prishin ekosistemet ujore vazhdon të kërcënojë rezervat e peshkut dhe habitatet e ujërave të ëmbla dhe detare.
4. Shkarkimet e kimikateve nga fabrikat e uzinat dhe ndotja e mjediseve natyrore mbeten problem për biodiversitetin.
5. Llojet invazive ose si mund ti quajmë llojet e bimëve dhe kafshëve që janë jo-vendase shkaktojnë zhdukjen e llojeve vendase dhe ndikojnë shërbimet e ekosistemit.
6. Ndryshimi i klimës është një nga presionet kryesore mbi biodiversitetin, me ndikime në sjelljen e llojeve dhe degradimin e vetë ekosistemeve.

Po çfarë duhet të bëjmë për ruajtjen e mbrojtjen e biodiversitetit

1. Krijimi dhe zbatimi i politikave për të mbrojtur dhe restauruar habitatet natyrore.
2. Krijimi i zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare dhe mirëmenaxhimi i tyre për të mbrojtur llojet e kërcënuara dhe jo vetëm.
3. Edukimi, ndërgjegjësim dhe informimi i publikut për rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit dhe ekosistemeve.
4. Studimi dhe monitorimi i llojeve të kërcënuara dhe ekosistemeve për të marrë masa të bazuara në fakte dhe të dhëna shkencore.
5. Zbatimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe pyjore që mbrojnë dhe ruajnë biodiversitetin.

Mbrojtja dhe ruajtja e biodiversitetit është thelbësore për të siguruar që ekosistemet të vazhdojnë të ofrojnë përfitime të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm. Me masa të koordinuara dhe përpjekje të përbashkëta, mund të ndalojmë humbjen e biodiversitetit dhe të mbrojmë llojet e kërcënuara, duke siguruar një të ardhme më të mirë për planetin tonë dhe brezat e ardhshëm.

### Marrëveshjet Ndërkombëtare (konventat)

Biodiversiteti ndikon në shumë aspekte të shoqërisë dhe sektorëve të ndryshëm, dhe është shumë i rëndësishëm në kontekstin shpirtëror, fetare dhe kulturor. Për t'iu përgjigjur sfidave të ndërlikuara, ka një numër të madh Marrëveshjesh Ndërkombëtare (konventa) dhe instrumente të politikës ndërkombëtare dhe rajonale të lidhura me biodiversitetin, duke përfshirë:

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara për Diversitetin Biologjik (<https://www.cbd.int/>)

2. Konventa mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES) <https://www.cites.org/>
3. Konventa Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Bimëve (IPPC) <https://www.ippc.int/en/>
4. Konventa për Mbrojtjen e Llojeve Shtegtuese të Kafshëve të Egra (CMS) <http://www.cms.int/>
5. Konventa mbi Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare Veçanërisht si Habitata të Shpendëve Ujore (e Ramsarit) <http://www.ramsar.org/>

Megjithatë, shumë prej këtyre konventave hasin vështirësi për gjetjen e mbështetjes së mjaftueshme dhe zbatimin efektiv të tyre në disa vende të rajonit.

## Treguesi synuar 15.6

Treguesi 15.6 synon të mbështesë ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i burimeve gjenetike dhe të nxitet aksesit i përshtatshëm në këto burime, siç është rënë dakord ndërkombëtarisht.

Që të kuptojmë më mirë këtë tregues të Objektivit 15 do duhet të dimë më shumë mbi Burimet Gjenetike.

Burimet gjenetike përfshijnë të gjitha llojet e kafshëve, bimëve, mikroorganizmave dhe jo vertebrorëve që përdoren për ushqim, bujqësi dhe pylltari. Këto burime mund të grupohen në disa kategori kryesore:

### 1. Burimet Gjenetike Bimore

- Rreth 10,000 lloje bimore janë përdorur dhe përdoren dhe sot për ushqim që nga fillimet e zhvillimit të bujqësisë. Sot, vetëm rreth 150 lloje bimore përbëjnë dietën e pjesës më të madhe të popullsisë së botës. Vetëm 12 lloje bimësh sigurojnë mbi 70% të ushqimit, ndërsa katër lloje (orizi, misëri, gruri dhe patatja) përbëjnë mbi 50% të furnizimit me ushqim.

### 2. Burimet Gjenetike Shtazore

- Diversiteti i burimeve gjenetike shtazore përfshin diversitetin e llojeve dhe racave. Aktualisht njihen rreth 8,800 raca të ndryshme të përdorura për ushqim dhe bujqësi, që iu përkasin 38 llojeve të shpendëve dhe gjitarëve.
- **Gjedhët, delet, dhitë, pulat dhe derrat** janë shpesh të referuara si "pesëshja e madhe". Por tek këto burime gjenetike përfshihen edhe kafshë të tjera si gamilet, gomarët, deveja, bualli, kali, lepuri, patat, rosat, strucët, thëllëzat, fazanët, pëllumbat dhe gjelat e detit.

### 3. Burimet Gjenetike Pyjore

- Tek Burimet Gjenetike Pyjore përfshihen materiale gjenetike (si ADNja) e pemëve dhe bimëve të tjera drusore që kanë vlerë ekonomike, mjedisore, shkencore ose shoqërore. Diversiteti gjenetik është i nevojshëm për mbijetesën, përshtatjen dhe zhvillimin e pemëve pyjore nën ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe mjedisore.

### 4. Burimet Gjenetike Ujore

- Këto përfshijnë të gjitha burimet gjenetike të organizmave që jetojnë në ujë: si peshqit, midhjet, oktapodët, gjitarët detarë, bimët ujore dhe organizmat e tjerë ujore. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve ujore gjenetike janë vendimtare për të përmbushur kërkesat në rritje për ushqim në botë.



## 5. Burimet Gjenetike të Mikroorganizmave dhe Jovvertebrorëve

- Edhe ky grup ku futen mikroorganizmat dhe jovvertebrorët në zinxhirin e vlerës së prodhimit bujqësor mund të sjellin përfitime apo të shkaktojnë dëme serioze.

Strategjia Evropiane për Ruajtjen e Burimeve Gjenetike përfshin masa për të ruajtur diversitetin e burimeve gjenetike për ushqim dhe bujqësi, duke përdorur metoda brenda fermës dhe ex-situ (jashtë fermës). Që nga viti 1970, janë krijuar koleksione ex-situ të burimeve gjenetike bimore, të njohura si banka e gjeneve, që aktualisht përmbajnë afërsisht një të tretën e koleksioneve globale ex-situ të burimeve gjenetike të kulturave bujqësore.

Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve gjenetike është thelbësore për të siguruar qëndrueshmërinë e ekosistemeve dhe për të përmbushur nevojat e ushqimit dhe bujqësisë në botë. Mbështetja për ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve dhe nxitja e aksesit të përshtatshëm në këto burime është një hap i rëndësishëm drejt arritjes së qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Shqipëria është palë në Protokollin e Nagojës mbi Aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve të Konventës për Diversitetin Biologjik (CBD).

### Treguesi synuar 15.7

Treguesi 15.7 synon ndërmarrjen e masave urgjente për të ndaluar gjuetinë ilegale dhe trafikimin e llojeve të mbrojtura të florës dhe faunës dhe për të adresuar si kërkesën dhe furnizimin me produkte ilegale të jetës së egër.

Gjuetia ilegale përfshin kapjen e paligjshme të kafshëve të egra dhe grumbullimin e paligjshëm të llojeve të bimëve të egra. Motivet për gjueti ilegale përfshijnë fitimin tregtar, konsumin për shtëpi, mbledhjen e trofeve, emocionin për të vrarë kafshë të egra, ose kundërshtimin e rregullave të gjuetisë.

Motivet e gjuetisë ilegale	Efektet e dëmshme të gjuetisë ilegale janë:
1. Shitja e mishit të kafshëve të egra dhe pjesëve të trupit të tyre.	1. Zvogëlimi i popullatave të kafshëve të egra
2. Sigurimi i ushqimit për familjet e varfra.	2. Humbja e faunës në pyje
3. Argëtimi dhe sporti i gjuetisë i cili më shumë lidhet me emocionin e gjuetarëve për të vrarë kafshë të egra.	3. Promovimi negativ për turizëm.
	4. Rritja e sëmundjeve zoonotike

### Shqipëria dhe masat kundër gjuetisë ilegale

Në Shqipëri është në fuqi një moratorium i gjuetisë (ndalimi i gjuetisë) që nga viti 2014 deri në vitin 2026, për të rimëkëmbur popullatat e faunës së egër. Ndërprerja e gjuetisë ilegale dhe trafikimit të llojeve të mbrojtura kërkon masa urgjente dhe koordinim ndërkombëtar. Ruajtja e biodiversitetit dhe mbrojtja e llojeve të rrezikuara janë thelbësore për të siguruar qëndrueshmërinë e ekosistemeve dhe për të mbrojtur trashëgiminë natyrore për brezat e ardhshëm.

### Treguesi synuar 15.8

Treguesi 15.8 synon që deri në vitin 2020 të paraqiten masa për të parandaluar futjen e llojeve invazive dhe të zvogëlohet ndjeshëm ndikimi i tyre në ekosistemet tokësore dhe ujore, dhe të kontrollohen ose të zhduken llojet me ndikim më të madh.



Llojet invazive janë bimë, kafshë, patogjenë dhe organizma të tjerë që nuk janë vendase (indigjenë) në një ekosistem dhe që mund të shkaktojnë dëm ekonomik, mjedisor ose ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut. Ato kanë një ndikim negativ mbi biodiversitetin, duke përfshirë rënien ose eliminimin e llojeve invazive nëpërmjet konkurrencës, gjuetisë ose transmetimit të patogjenëve, dhe pengimit të ekosistemeve lokale dhe funksioneve të tyre.

### **Karakteristikat e llojeve invazive**

1. Riprodhimi dhe rritja e shpejtë: Aftësia për të riprodhuar dhe rritur shpejt në numër.
2. Shpërndarja e lartë: Kapaciteti për t'u përhapur lehtë dhe shpejt në mjedise të reja.
3. Përshtatshmëria mjedisore: Aftësia për të mbijetuar në një gamë të gjerë kushtesh mjedisore dhe për t'u ushqyer me shumë lloje të ndryshme të ushqimit.

### **Problemet e llojeve invazive**

Që nga shekulli i 17-të, llojet invazive kanë kontribuar në rreth 40% të zhdukjeve të kafshëve. Problemi vazhdon të rritet, me kosto të mëdha socio-ekonomike, ekologjike dhe shëndetësore në mbarë botën. Llojet invazive përkeqësojnë varfërinë dhe kërcënojnë zhvillimin duke ndikuar në sektorë si bujqësia, pylltaria, peshkimi dhe sistemet natyrore.

### **Situata e llojeve invazive në Shqipëri**

Në Shqipëri janë regjistruar 47 lloje invazive të faunës së huaj. Përsa i përket florës, situata është më shqetësuese, me 196 lloje të huaja të përshtatura dhe kultivuara në kushtet e vendit. Ndikimet e florës së huaj janë të ndryshme dhe ndryshojnë nga ajo e shumicës së vendeve evropiane.

1. Masa të rrepta për të parandaluar futjen e llojeve invazive në vend.
2. Programet për të kontrolluar ose zhdukur llojet invazive që janë tashmë të pranishme.
3. Sisteme të avancuara për monitorimin dhe vëzhgimin e ekosistemeve për të identifikuar dhe reaguar shpejt ndaj llojeve invazive.
4. Edukimi i publikut për rreziqet e llojeve invazive dhe rëndësinë e mbrojtjes së biodiversitetit.
5. Bashkëpunimi me vende të tjera dhe organizata ndërkombëtare për të ndarë informacion dhe burime për të luftuar llojet invazive.

Lufta kundër llojeve invazive është thelbësore për mbrojtjen e biodiversitetit dhe ruajtjen e ekosistemeve natyrore. Kjo kërkon përpjekje të koordinuara nga autoritetet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen aktive të publikut.



# Aktivitete OZHQ 15

## Aktiviteti 1: Zinxhiri Ushqimor në Natyrë

---

**Përshkrimi:** Lojë dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë në skuadër

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Fill spango i gjatë deri në 50 metra i mbledhur në një lëmsh. Fletë informuese ku janë përshkruar rolet e personazheve të lojës. Mund të përdorim dhe kapele letre ku të jenë vizatuar figurat e personazheve si dielli, bimë, kafshët etj.

### Procedura:

- Loja fillon me ndarjen e roleve midis fëmijëve. Më pas ata formojnë një rreth.
- Fëmija që është “dielli” qëndron në qendër të rrethit. Disa fëmijë janë “mikroorganizmat”, ndërsa të tjerët janë bimë dhe kafshë të ndryshme.
- Drejtuesi i lojës i jep lëmshin e fillit të spangos fëmijës Diell. Të gjithë fëmijët e dinë se sa shumë i rëndësishëm është dielli për jetën në tokë. Rrezatimi diellor direkt do të kapet nga bimët, sepse vetëm bimët mund ta përthithin energjinë diellore dhe pastaj ta shndërrojnë në një formë, të cilën organizmat e tjerë e shfrytëzojnë si energji. Dielli pason topin tek një anëtar i skuadrës që është në rolin bimës. Çdo anëtar do të marrë e mbajë në dorë një pjesë nga litari i gjatë. Ata do të lidhen si në zinxhirin ushqimor. Duhet të ketë shumë lidhje midis organizmave të ndryshëm — p.sh. të gjitha bimët të jenë të lidhura me diellin. Por bimët konsumohen nga kafshët, e kështu me rradhë.
- Pasi ta formoni zinxhirin, drejtuesi i lojës ju tregon fëmijëve se po vjen dimër i ftohtë, i cili do të shkatërrojë disa prej bimëve, prandaj disa nxënës do të duhet të ulen. Pas dimrit minjtë dhe larvat (ose kafshët tjera) nuk kanë ushqim të mjaftueshëm dhe ngrohin, prandaj edhe ata nxënës ulen etj. Së shpejti, të gjithë do të ulen, përveç diellit, tokës, ujit, ajrit dhe mikroorganizmave. Mikroorganizmat mund të kërcejnë lart e poshtë për të treguar se sa janë të lumtur që kanë ushqim të mjaftueshëm.

### Vijueshmëria e aktivitetit:

Pasi mbaron loja do të diskutojmë në lidhje me gjithë procesin dhe lidhjet e zinxhirit ushqimor. Ju mund të tregoni si mikroorganizmat do të zbërthejnë trupat në lëndët bazë, të cilat do ta pasurojnë tokën. Bimët sërish do të rriten, dhe larvat do të kenë çfarë të hanë. Kështu secili fëmijë do të ngrihet ashtu siç lloji i vet kthehet në jetë pas ndryshimit.

Bisedoni me shokët se çdo organizëm i gjallë është një lloj i rëndësishëm në zinxhirin ushqimor.

*Theksoni faktin se zhdukja e një lloji ndikon në ekzistencën e llojeve të tjera, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë janë të lidhura me të. Njeriu, me sjelljen e vet duhet të ndihmojë për ruajtjen e llojeve të ndryshme të botës së gjallë.*

## Aktiviteti 2: Shtegtimi i lejlekut

---

**Përshkrimi:** Lojë dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen vlerat e përqindjet për secilin nxënës

### Procedura:

**Njihemi me rregullat e lojës**

- Shënoni në tokë dy rrathë me diametër 2 metra, të cilët duhet të jenë larg njëri tjetrit 30-40 hapa. Njëri do të përfaqësojë vendin për dimërim të lejlekëve, ndërsa tjetri vendin e folesë së tyre. Siguroni katër-pesë vende midis dy rrathëve si zona të sigurta, ku lejlekët do të mund të pushojnë gjatë shtegimit.
- Në aktivitetin “Shtegtimi i shpendëve”, fëmijët janë lejlekët e bardhë, që grumbullohen çdo vjeshtë e shtegtojnë në jug për ta kaluar dimrin, ndërsa në pranverë kthehen në veri.
- Zona të sigurta mund të jenë pemët, shkëmbinjtë e mëdhenj, moçalet ose disa vende të tjera natyrore, në të cilat zogjtë mund të fluturojnë.
- Fëmijët duhet të zgjedhin role të rastësishme. Dy nxënës do të kenë rolin e gjuetarëve (njeriu dhe grabitqari, p.sh. dhelpra), ndërsa fëmijët e tjerë kanë rolin e lejlekëve. Zogjtë lëvizin shumë shpejt, fluturojnë nga njëri rajon te tjetri dhe mund të ndalen vetëm në zonat e sigurta gjatë kalimit të tyre. Gjuetarët mundohen që t’i gjuajnë zogjtë në kohën kur ata shtegtojnë, por nuk mund të hyjnë në zonat e sigurta, në vendet për dimërim dhe në fole. Secili zog i gjuajtur del nga loja.
- Fillimin e shtegimit e njofton njëri prej fëmijëve, që është drejtuesi i lojës (ose mësuesi). Gjatë shpërnguljes së parë, të gjitha zonat janë aktive. Por, para se të fillojë e dyta, drejtuesi i lojës duhet t’iu tregojë fëmijëve të tjerë se njëra prej zonave është kënetë e tharë dhe nuk mund të shfrytëzohet më. Para se të fillojë shpërngulja e tretë, në një zonë tjetër të sigurt janë ndërtuar disa hotele, kështu që edhe ajo nuk mund të shfrytëzohet. Loja vazhdon deri sa të zhduken të gjitha zonat e sigurta. Drejtuesi duhet të përdorë arsye të ndryshme për shkatërrimin e zonave të sigurta — ndërtimin e fabrikave ose autostradës, shndërrimin e zonës me ujë në qendër pushimi, Është e qartë se ata do të gjuhen më lehtë nga gjuetarët, pasi ngelin gjithnjë e më pak zona të sigurta. Nëse lejlekët ankohen se kjo nuk është e drejtë, tregojuni atyre se gjuetarët mundohen t’i gjejnë vendet ku pushojnë zogjtë gjatë fluturimit të tyre. Kur zonat e sigurta janë shkatërruar, është shumë e vështirë që zogjtë të mbijetojnë gjatë shpërnguljes. Sa është numri i lejlekëve që kanë mbijetuar pas secilës shpërngulje?

### **Diskutime**

Pas lojës organizoni një diskutim lidhur me pyetjet e mëposhtme:

- Pse është biodiversiteti i rëndësishëm për njerëzit?
- Çfarë çon në zhdukjen e një lloji?
- Çfarë mund të bëjmë ne për të mbrojtur bimët dhe kafshët?
- Fëmijë si jeni ndjerë gjatë lojës “Shtegtimi i lejlekut”?
- Cili ka qenë roli juaj në këtë lojë?
- A ka qenë e vështirë për të mbijetuar?
- A e dini ju fëmijë që gjatë shtegimit të shumë shpendëve, si dhe në lojën tuaj, shpesh vendet e pushimeve janë plot me gjuetarë e grabitqarë, të cilët rrezikojnë jetën e tyre?

Por ka dhe shumë kërcënime të tjera që i rrezikojnë ata, p.sh: kabllot elektrike, mungesa e ushqimit, helmet që përdoren në bujqësi ose njollat e naftës në shtretërit e ujërave.

## **Aktiviteti .3: Një pikë: Përse na nevojitet infrastruktura e gjelbër**

**Përshkrimi:** Video dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** diskutim në grup

**Kohëzgjatja:** 45 minuta

**Materialet:** Linku i videos: <https://www.youtube.com/ëatch?v=vMallfLsfOc>

### Procedura:

- Shfaqni videon duke klikuar në linkun e saj.
- Pasi të shfaqni videon “Një pikë: Përse na nevojitet infrastruktura e gjelbër”, diskutoni rreth pyetjeve:
  - ✓ Pse lumenjtë janë të rëndësishëm?
  - ✓ Cili është ndikimi i industrisë në lumenj?
  - ✓ Si mund të zvogëlohet ndotja e lumenjve?
  - ✓ A keni ndonjë ide si mund të kontribuoni në zvogëlimin e ndotjes në lumenjtë e rajonit tuaj (me ide plotësuese, që nuk përmenden në video)?

## Aktiviteti 4: Duhet ndërtuar apo jo

---

**Përshkrimi:** Loja e Dilemës dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale

**Kohëzgjatja:** 30 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohet situata dhe mundësitë e zgjedhjes për nxënësit.

### Procedura:

1. Prezantoje tek nxënësve rastin më poshtë:

*Një biznesmen i huaj ka kërkuar leje për ndërtimin e një kompleksi turistik brenda kufijve të një parku kombëtar i cili përfshin liqenin dhe mjediset përreth tij. Kompleksi përfshin 30 vila luksoze me sipërfaqe prej 520 m<sup>2</sup>, shëtitore, restorante, pishina dhe marina. Për momentin strukturat e banimit nuk janë ngritur akoma.*

Paraqit dilemën dhe kërkoju nxënësve të zgjedhin një mundësi:

- Ndërtimi i kompleksit duhet të lejohet
- Ndërtimi i kompleksit nuk duhet të lejohet
- Ndërtimi duhet të lejohet, por jo me këtë shtrirje urbane
- Mundësi të tjera

Nxënësit duhet të justifikojnë zgjedhjen dhe të japin shpjegimet e mundshme. Disa mund të jenë:

- Ndërtimi i kompleksit duhet të lejohet sepse shteti do të gjenerojë të ardhura nga shitja e tokës, Parku Kombëtar do të nxjerrë të ardhura nga taksat, turistët do të kenë mundësi të shohin natyrën e bukur dhe biodiversitetin e pasur të zonës
- Ndërtimi i kompleksit nuk duhet të lejohet sepse ndërtimi i një kompleksi të këtyre përmasave do të sjellë degradimin e habitateve natyrore, krijon problemin e ujërave të përdorur, të ndotjes së shkaktuar nga anijet, shqetësim të kafshëve.
- Ndërtimi duhet të lejohet, por jo me këtë shtrirje urbane sepse ndërhyrjet e vogla urbane krijojnë më pak degradim dhe çështja e ujërave të përdorur është më e lehtë për t'u zgjidhur

## Aktiviteti 5: Ekosistem natyror

---

**Përshkrimi:** Vizitë në terren, studim, kërkim dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale

**Kohëzgjatja:** 1 ditë

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen vlerat e përqindjet për secilin nxënës

### **Procedura:**

1. Nxënësit vizitojnë një ekosistem natyror pranë vendbanimit/qytetit/fshatit të tyre, që duhet restauruar. Ata ndahen në grupe dhe hetojnë:

- a) Cilat veprimtari njerëzore kanë shkaktuar degradimin e tij
- b) Si mund të restaurohet ekosistemi – propozoni masat e duhura
- c) Cilat subjekte shtetërore (komuniteti vendor, ministria) janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarive të lidhura me restaurimin

Pas disa ditësh (kohë e nevojshme për përgatitjen e prezantimeve) ata paraqesin gjetjet.

2. Nëse realizimi i vizitës është i pamundur, nxënësve mund t'u jepet detyra të kërkojnë (në internet, media, literaturë, vrojtime) në lidhje me temën. Atyre u jepen 2 javë për kërkimin dhe pas kësaj të paraqesin gjetjet.

## **Aktiviteti 6: Pyjet Evropiane**

---

**Përshkrimi:** Shfaqje videosh dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjues me ngjyra të ndryshme)

Linku videos: <https://www.youtube.com/ëatch?v=9UXrdËVQSL0>

### **Procedura:**

- Shfaqni videon duke klikuar në linkun e saj.
- Pas prezantimit të videos “Pyjet Evropiane” diskutoni mbi rëndësinë e pyjeve dhe përdorimit të qëndrueshëm të tyre.
- Pyetjet për diskutim: Pse janë të rëndësishëm pyjet? (për ekonominë, mjedisin, ndryshimet klimatike, tokën, kafshët dhe perspektivën sociale dhe kulturore).

## **Aktiviteti 8: Ruajtja e bletëve**

---

**Përshkrimi:** Shfaqje videosh dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Tabela, fletë ku do të shënohen, markera (shënjues me ngjyra të ndryshme)

Linku videos: <https://www.youtube.com/ëatch?v=ZI45LYL5DOg>

### **Procedura:**

- Shfaq videon “Ruajtja e bletëve” dhe diskutoni.
- Jepu nxënësve si detyrë të përgatisin një projekt me temën “Bëj diçka – shpëto një gjallesë”, që të mbulojë komponentët më poshtë:
  - *Identifikimin e llojit që do të merrni përsipër të “shpëtoni” (pelikanin, një orkide, lloje të mbrojtura);*
  - *Veprimtaritë që do të realizoni për të mbrojtur/përmirësuar popullatën e llojit të zgjedhur;*

- *Fushatë ndërgjegjësimi të publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së llojit të caktuar;*
  - *Rezultatet e pritura;*
  - *Strukturën financiare të projektit;*
- Propozimi mund të përmbajë informacione shtesë, nëse vlerësohet e rëndësishme;
  - Nxënësit mund të punojnë në grupe ose individualisht.

Dy javë më pas, ata e paraqesin projektin dhe bëjnë komentet përkatëse.

## Aktiviteti 9: Gjenet dhe Biodiversiteti

---

**Përshkrimi:** Shfaqje videosh dhe diskutim

**Pjesëmarrësit:** Punë individuale dhe në grup

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Materialet:** Linku videos: <https://www.youtube.com/ëatch?v=XOxsjdB4-ZQ>

### **Procedura:**

Shfaq videon “Gjenet dhe Biodiversiteti” dhe diskutoni rreth rëndësisë së ruajtjes së gjeneve.

- Çfarë është fondi gjenetik / shumëllojshmëria gjenetike?
- Shpjego rëndësinë që ka ai për natyrën dhe bujqësinë.
- Çfarë ndikon në zvogëlimin e shumëllojshmëria gjenetike? Cilat janë pasojat e tij?



## Referenca

---

<sup>1</sup>(1) Puna jonë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Shqipëri.  
<https://albania.un.org/sq/sdgs>.

(2) Qytete dhe komunitete të qëndrueshme - The United Nations in Albania.  
<https://albania.un.org/sq/sdgs/11>.

(3) MANUAL PËR BIZNESET - The United Nations in Albania.  
[https://albania.un.org/sites/default/files/2021-09/FINAL-SDG%20Manual\\_Shqip.pdf](https://albania.un.org/sites/default/files/2021-09/FINAL-SDG%20Manual_Shqip.pdf).

(4) Sustainable Development Goal 17: Partneritet për objektivat. | Kombet e ....  
<https://albania.un.org/sq/sdgs/17>.

(5) <https://sdgs.un.org/goals>